



**AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË**

**RAPORT I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK**

**Master i Shkencave në “Financë” me profile “Bankat dhe “Tregje  
Financiare”, “Kontabilitet dhe Raportim Financiar”, “Auditim dhe  
Menaxhim Risku”**

**ofruar nga**

**“Universiteti European i Tiranës”**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

**Prof.Dr. Drin Salko**  
**Prof.Dr. Artur Ribaj**

**Prill 2024**

**TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT****Master i Shkencave në "Financë"**

1	IAL aplikues:	Universiteti European i Tiranës
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Ekonomiksit dhe Financës
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master i Shkencave në "Financë" me profile "Bankë dhe Tregje Financiare", "Kontabilitet dhe Raportim Financiar", "Auditim dhe Menaxhim Risku" *
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	VKM Nr. 74, datë 21.01.2009
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	MASR me shkresën Nr. 8244/1 Prot., datë 04.09.2018
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	-
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	Vendim nr. 33, datë 13.07.2018
8	Cikli i studimit:	Cikli i Dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 Vite/4 semestra
10	Kreditet në total (ECTS):	120 Kredite (ECTS)
11	Forma e studimit:	Kohë e plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha Shqipe
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 7
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	Viti 2021-2022: PAE 13/1 PAK 2022-2023: PAE 14/1 PAK
18	Numri i studentëve:	Viti 2021-2022: Nr.Stud. 94 2022-2023: Nr.Stud. 96
19	Komente / të tjera:	-

\* Më datë 02.01.2022, me shkresë zyrtare Nr. 41/1 Prot, dërgohen profilet aktive të programit të studimit në proces akreditimi. Master i Shkencave në "Financë" me 3 profile aktive : "Bankë dhe Tregje Financiare", "Kontabilitet dhe Raportim Financiar", "Auditim dhe Menaxhim Risku".



## 1.1 PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i ciklit të dytë të studimit Master i Shkencave në “Financë”, me kohëzgjatje 2 vite akademike, është licencuar për herë të parë në vitin 2009, si Diplomë e Nivelit të Dytë (DND) Financë Bankë me profile: “Bankë dhe Tregje Financiare”, dhe “Ekonomi Financë”, me Vendim Nr.74, dt. 21.01.2009 të Këshillit të Ministrave. Programi u akreditua për herë të parë në vitin 2011 me Urdhër të MASH Nr.68, dt. 14.02.2011. Akreditimi i dytë periodik i programit u bë me Vendim të Bordit të Akreditimit nr.33, datë 13.07.2018.

Bazuar në vendimin e Senatit Akademik Nr. 07, datë 14.06.2018 programi u përshtat në përputhje me ndryshimet e legjislacionit në fuqi, dhe prej vitit akademik 2018-2019 u ofrua me profilet: Bankë dhe Tregje Financiare, Ekonomi Financë, Kontabilitet dhe Raportim Financiar, Auditim dhe Menaxhim Risku, Menaxhim dhe Vlerësim Projektsh. Profilet Ekonomi Financë dhe Menaxhim dhe Vlerësim Projektsh u mbyllën me Vendim Senati nr. 11, datë 26.03.2021 për shkak të numrit të vogël të studentëve që patën interes në këto programe.

Përpara fillimit të vitit akademik 2022-2023 bazuar në vendimin e Senatit Akademik Nr. 5, datë 20/09/2022 kurrikula e programit u rishikua përsëri, në përmbyllje të punës së kryer nga Departamenti për përditësimin e fondit të lëndëve, me qëllim shmangien e mbivendosjes së përsëritjeve të temave në module, si brenda programit ashtu edhe nga cikli bachelor në master, si edhe për t’iu përgjigjur më mirë kërkesave të tregut të punës dhe përditësimit me zhvillimet më të fundit në fushën e Financës. Ndryshimet në kurrikulën e programit të studimit ishin më pak se 20 % e numrit të krediteve të cilat kërkojnë miratimin e Senatit të UET.

Me mbylljen e dy profileve, UET ka kërkuar akreditimin e programit MSH në Financë vetëm për 3 (tre) profilet aktive të tij, konkretisht:

- a. Bankë dhe Tregje Financiare
- b. Kontabilitet dhe Raportim Financiar
- c. Auditim dhe Menaxhim Risku

*Më datë 02.01.2022, me shkresë zyrtare Nr. 41/1 Prot, dërgohen profilet aktive të programit të studimit në proces akreditimi.*

Programi ofrohet nga Departamenti i Ekonomiksit dhe Financës, pjesë e Fakultetit të Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit, i licencuar si Fakulteti Ekonomik me VKM Nr. 255, datë 27.02.2008, dhe riorganizuar me Urdhër të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Nr. 527, datë 04.09.2018.

Programi i studimit realizohet me 120 kredite (ECTS), në gjuhën shqipe, me formë studimi me kohë të plotë, me kohëzgjatje normale 2 vite akademike (4 semestra), në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i Shkencave” në “Financë” me një nga profilet përkatëse të shprehura më lart.

Objektivi kryesor i këtij programi është të përgatisë profesionistë dhe financierë të aftë për të përballuar me sukses kërkesat e tregut të punës, në drejtim të tregjeve financiare, sektorit bankar, kontabilitetit dhe

auditimit, pavarësisht dinamikave dhe ndryshimeve të vazhdueshme në mjedisine biznesit.

## 1.2 PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm, i përbërë nga Prof.Dr. Drini Salko dhe Prof.Dr.Artur Ribaj, i miratuar nga Bordi i Akreditimit dhe ASCAL, mbështetur në këtë proces nga koordinatori teknik i ASCAL, Rajna Lila, në realizimin e procesit të vlerësimit të jashtëm, u mbështet në një seri dokumentesh dhe kërkesash të ndryshme në lidhje me standardet dhe mënyrën e funksionimit të njësive përkatëse që mbulojnë këtë program. GVJ përdori dokumentacionin që ka vënë në dispozicion Agjencia e Sigurimit të Cilësisë të Arsimit të lartë (ASCAL), në faqen e saj zyrtare, në dokumentacionin shtesë, të kërkuar në institucionin të administruar zyrtarisht. Burim i rëndësishëm për vlerësimin e jashtëm shërbeu Raporti i Vlerësimit të Brendshëm (RVB), i cili është rezultat i bashkëpunimit ndërmjet stafit akademik dhe atij administrativ dhe pasqyron nivelin e plotësimit të programit të studimit për 6 fushat dhe kriteret përkatëse të tyre si dhe situatën e procesit të formimit dhe të zhvillimit në ne institucion (Universitetin European të Tiranës), njësinë kryesore (Fakultetin e Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit) dhe njësinë baze ( Departamentin e Ekonomiksit dhe Financës). Një rol të rëndësishëm në këtë vlerësim pati vizita në vend që u realizua pranë institucionit aplikues në datat 20 dhe 21 Shtator 2023. Në bazë të agjendës së përgatitur paraprakisht dhe të dakordësuar me institucionin, u realizuan takime me drejtues të njësive kryesore/bazë e struktura të tjera të këtij institucioni, ku u verifikuan dhe u shqyrtuan edhe një sërë dokumentesh të dosjes përkatëse të aplikimit për akreditim të këtij programi. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm kërkoi dhe dokumentacion shtese nga institucioni i cili u dërgua dhe u pasqyrua ne sistem nga koordinatorja teknike e ASCAL-it.

Gjatë vizitës në Institucion u realizuan takime me: Rektorin, Dekanin e FEBZH, Përgjegjës të DEF, Grupin e Vetëvlerësimit, stafin akademik që mbulon programin e studimit, studentët, Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Zyrën e Kurrikulës dhe Cilësisë, Zyrën e Këshillimit të Karrierës dhe Alumni, Zyrën e Shërbimit të Studentëve, Zyrën e Marrëdhënieve me Jashtë, Zyrën e Hartimit dhe Menaxhimit të Projekteve, Zyrën e Burimeve Njerëzore dhe Sekretarinë Mësimore. Gjithashtu, u realizua një vizitë edhe në mjediset mësimdhënëse të këtij Institucioni, sallën e kompjuterëve, bibliotekë, etj.

Në verifikimin e të dhënave u përdor metoda e marrjes së mostrës, duke nxjerrë në mënyrë të rastësishme kampionët për verifikim. Kjo metodë u përdor në verifikimin e të dhënave lidhur me cilësinë e studentëve, të dhënat e studentëve në sekretari, të dhënat për hyrje dhe dalje të studentëve në vite, lidhur me frekuentimin e leksioneve dhe të seminareve, verifikimin e praktikave të rekrutimit të stafit, etj.

Raporti i Vlerësimit të Jashtëm (RVJ) përbëhet nga 6 standarde kryesore me kriteret e tyre përkatëse. Çdo standard është analizuar dhe vlerësuar, nëpërmjet kriteve përkatëse.



Analiza përmban vlerësimin për çdo kriter të secilit standard, duke vlerësuar të dhënat e deklaruara në Raportin e Vlerësimit të Brendshëm (RVB) të përgatitur nga institucioni, evidencat për çdo standard dhe kriter përkatës, evidenca shtesë të kërkuara nga GVJ si dhe nga evidentimet nga vizita e GVJ-së në Institucion .

Ekspertët kanë evidentuar ndryshimet dhe kanë vlerësuar nëse ka ndryshime dhe sa këto ndryshime ndikojnë në përmbushjen e standardeve që lidhen me kriteret specifike.

Për secilin standard dhe kriter përkatës, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) është përgjigjur konkretisht nëse plotësohet apo jo dhe për shkallën e vlerësimit si dhe një koment në fund të çdo kriteri për të 6 (gjashtë) standardet.

Raporti përmbillet me një analizë përmbledhëse të anëve të forta dhe të dobëta lidhur me programin e studimit: Master Shkencor në “Financë” me 3 profile.

Së fundmi, vlerësojmë bashkëpunimin me të gjithë strukturat përkatëse të Institucionit që na mundësuan plotësimin e kërkesave tona për dokumentacion shtesë, lidhur me aspekte të caktuara në shërbim të një vlerësimi sa më objektiv.



## 1.2. SHKALLA E PERMBUSHJES SË REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I FUNDIT

### I. Rekomandimet e Bordit të Akreditimit

Akreditimi periodik i programit Master Shkencor në “Financë-Bankë” është sipas Vendimit të Bordit të Akreditimit Nr. 33, datë 13.07.2018, për “Akreditimin periodik të programit të studimit të ciklit të dytë, Master i Shkencave në Financë - Bankë, me profile: “Banka dhe Tregje Financiare” dhe “Ekonomi - Financë”, të Universitetit Europian të Tiranës. Mbështetur në rezultatet e procesit të vlerësimit të brendshëm dhe të jashtëm, Bordi i Akreditimit vendosi:

Vlerësimin Përfundimtar “Pozitiv” për programin e studimit “Master i Shkencave në Financë-Bankë”, me dy profilet e mësipërme, dhe me kohëzgjatje prej 5 (pese) vite akademike, me vlefshmëri deri më 30/09/2023 dhe me rekomandime si ne vijim:

1. *Institucioni të përmirësojë raportin udhëheqës/student, me qëllim uljen e numrit të lartë të temave të diplomave të udhëhequra nga i njëjti pedagog.*
2. *Institucioni të shtojë mbështetjen për stafin akademik me qëllim përfshirjen e tyre në projekte kërkimore ku përfshihen edhe studentët.*
3. *Institucioni të shohë mundësinë e ofrimit e të paktën një lënde mësimore në gjuhë të huaj, me qëllim ndërkombëtarizimin e këtij programi studimit.*

### II. Plotësimi i rekomandimeve nga Institucioni

#### Rekomandimi 1:

- *Institucioni të përmirësojë raportin udhëheqës/student, me qëllim uljen e numrit të lartë të temave të diplomave të udhëhequra nga i njëjti pedagog.*

Bazuar në të dhënat e marra nga institucioni në RVB si dhe nga takimi me stafin akademik evidentojmë se krahasuar me periudhën e akreditimit të fundit ka përmirësim në raportin pedagoge udhëheqës/ numër studentesh. Numri i studenteve të udhëhequr nga një pedagog është ulur nga 15 deri 20 studente në vitin akademik 2017-2018 në 10 deri 15 studente në vitin akademik 2022-2023.

Megjithatë GVJ vlerëson se ende ky numër është relativisht i lartë dhe që përben pengesë për një udhëheqje me cilësore të punimeve përmbyllëse të programit të studimit.

**GVJ vlerëson se rekomandimi është plotësuar kryesisht.**



### **Rekomandimi2:**

- *Institucioni të shtojë mbështetjen për stafin akademik me qëllim përfshirjen e tyre në projekte kërkimore ku përfshihen edhe studentët*

Bazuar në të dhënat e marra nga institucioni në RVB si dhe nga takimi me stafin akademik evidentojmë se krahasuar me periudhën e akreditimit të fundit institucioni, njësi kryesore dhe ajo baze ka shtuar mbështetjen për stafin akademik të programit GVJ evidenton se stafi akademik :

- ❖ Ka qene aktiv dhe i suksesshëm në fitimin e një numri të konsiderueshëm projektesh kërkimore shkencore si dhe realizimin me sukses të tyre brenda afateve të miratuara. ( Shih vlerësimin në RVJ )
- ❖ Është rritur në mënyre sinjifikative pjesëmarrja e studenteve në aktivitete dhe projekte shkencore
- ❖ Institucioni mbështet financiarisht drejtpërdrejt stafin akademik dhe studentet në aktivitete të ndryshme mësimore shkencore (nëpërmjet fondit kërkimor shkencor të institucionit dhe intershipeve në kuadër të projektit ERASMUS +.

**GVJ vlerëson se rekomandimi është plotësuar plotësisht.**

### **Rekomandimi 3:**


- *Institucioni të shohë mundësinë e ofrimit e të paktën një lënde mësimore në gjuhë të huaj, me qëllim ndërkombëtarizimin e këtij programi studimit.*

Në kuadër të ndërkombëtarizimit UET tashme ofron disa programe studimit në gjuhën angleze në ciklin e parë të studimit ku një prej tyre ofrohet nga DEF si njësi kryesore e këtij programi. Studentet e programit MSH në Financë e kanë të detyrueshme zotërimin e gjuhës së huaj. Në këtë kuadër GVJ vlerëson se krahas literaturës në gjuhë të huaj që ofrohen në programin e lendeve (syllabuset), institucioni ka realizuar me stafin akademik dhe atë të ftuar edhe leksione në gjuhë të huaja me studentet e programit.

**GVJ vlerëson se rekomandimi është plotësuar plotësisht.**

## LISTA E SHKURTIMEVE

<b>ASCAL</b>	<b>Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë</b>
<b>DEF</b>	<b>Departamenti i Ekonomiksit dhe Financës</b>
<b>FEBZH</b>	<b>Fakulteti i Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit</b>
<b>GVB</b>	<b>Grupi i Vlerësimit të Brendshëm</b>
<b>GVJ</b>	<b>Grupi i Vlerësimit të Jashtëm</b>
<b>KPSSC</b>	<b>Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë</b>
<b>MSH</b>	<b>Master i Shkencave</b>
<b>KSBC</b>	<b>Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë</b>
<b>QSHA</b>	<b>Qendra e Shërbimeve Arsimore</b>
<b>RASH</b>	<b>Rrejtja Akademik Shqiptar</b>
<b>RVB</b>	<b>Raport i Vlerësimit të Brendshëm</b>
<b>SBC</b>	<b>Sigurimi i Brendshëm i Cilësisë</b>
<b>UET</b>	<b>Universiteti Europian i Tiranës</b>
<b>VKM</b>	<b>Vendim i Këshillit të Ministrave</b>





## Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në “Financë”

### I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

<b>Standardi I.1</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.</b></p> <p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.</p>	<p>Programi i studimit të ciklit të II-të Master i Shkencave (MSH) në “Financë”, me 3 profile i ofruar nga Universiteti European i Tiranës (UET), Fakulteti i Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit (FEBZH), Departamenti i Ekonomiksit dhe Financës (DEF), në të gjithë komponentët e tij nuk bie ndesh me interesat kombëtare por i shërben këtyre të fundit. Si një program në fushën e financës i shërben përgatitjes dhe kualifikimit të studenteve në shërbim të interesave kombëtare në përgjithësi dhe zhvillimit ekonomik të vendit në veçanti.</p> <p>Programi i studimit MSH në “Financë” është hartuar në zbatim të Ligjit në fuqi për Arsimin e Lartë, akteve nënligjore dhe kuadrin rregullues të tij si dhe në ish Planin Strategjik 2015-2020 dhe Planin Strategjik aktual 2021-2025 të UET-së. Në funksion të kësaj strategjie institucionale është hartuar edhe Plani strategjik i vetë programit të studimit MSH në “Financë” me tre profile. Ky program reflekton vlerat akademike e kulturore, standarde të arsimit të lartë në Shqipëri. Ky vlerësim bazohet në plotësimin e kriterëve thelbësorë të këtij programi në aspektin akademik dhe atë kulturor bazuar edhe në Statutin e UET. Parë në tërësi, programi synon përcjelljen tek studentët si të vlerave akademike, ashtu dhe të atyre kulturore në shërbim të sektorit ekonomik të vendit në përgjithësi dhe fushës së financës në veçanti.</p> <p><i>Evidence nr.2.Statuti i UET</i> <i>Evidence nr.3. Plani Strategjik i UET 2021-2025</i> <i>Evidence nr.4.Plani strategjik për zhvillimin e programit të studimit MSH në Financë me tre profile</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe</p>	<p>Programi i studimit MSH në “Financë” me tre profile është hartuar në mbështetje të qëllimit dhe misionit të UET-së dhe FEBZH si njësi kryesore e tij, të shprehura në Statutin e UET( neni nr.6), Strategjinë e kërkimit shkencor 2021-2025 të institucionit me fokus</p>



<p>misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.</p>	<p>përgatitjen e studentëve me njohuritë bashkëkohore teorike, shkencore dhe praktike në fushën e financës, bankës, kontabilitetit dhe menaxhimit të riskut. Ne funksion të kësaj strategjie është edhe operimi i njësisë bazë të këtij programi, DEF, si njësi baze që mbulon këtë program, pjesë e FEBZH të UET-së. Ky program plotëson më mirë nevojat në fushën e veprimtarisë ekonomike të lidhura me aplikimin e programeve bashkëkohore në fushën e financës dhe të tre profileve të përfshira në këtë fushe; “Bankë dhe Tregje Financiare”, “Kontabilitet dhe Raportim Financiar”, “Auditim dhe Menaxhim Risku”.</p> <p><i>Evidence nr.2.Statuti i UET</i>  <i>Evidencë nr.3. Plani Strategjik i UET 2021-2025</i>  <i>Evidence nr.4.Plani strategjik për zhvillimin e programit të studimit MSH ne Financë me tre profile</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimit akademike së Institucionit.</p>	<p>Programi i studimit MSH në “ Financë” me tre profile është hartuar në përputhje me Statutin e UET, Planin strategjik të institucionit për periudhën 2021-2025 (pika nr.8) dhe veçanërisht ne Planin strategjik për zhvillimin e vete programit. Ne objektivat strategjik të këtij programi (faqja nr.4, pika 1,2 dhe 3) theksohet pajisja e studenteve me formim akademik shkencor dhe koncepte të thelluara ne fushën e financës. Ky program, i strukturuar ne baze të ndryshimeve ligjore ne vitin akademik 2018 ( Vendim Senati UET nr.7.dt.14.06.2018 ), reflekton synimin e institucionit dhe veçanërisht njësisë bazë të tij, DEF, për të zhvilluar këtë program. Strategjia e pare institucionit (2015-2020 )që përkon po me këtë periudhe mëshirohet qe ne këtë kohe edhe objektivat e këtij programi.</p> <p><i>Evidence nr.2.Statuti i UET</i>  <i>Evidencë nr.3. Plani Strategjik i UET 2021-2025</i>  <i>Evidence nr.4.Plani strategjik për zhvillimin e programit të studimit MSH ne Financë me tre profile</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit,</p>	<p>Ky program studimi i shërben zhvillimit kombëtar dhe lokal të ekonomisë. Në këtë këndvështrim, ky program studimi, nëpërmjet përgatitjes së studentëve me njohuritë teorike shkencore por edhe aplikative në fushën e financës, dhe të tre drejtimeve karakterizuese</p>




<p>interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar.</p>	<p>të kësaj fushe, institucionet financiare, kontabilitet auditimin dhe menaxhim risku. Kjo e bën më tërheqëse marrjen e njohurive në të tre këto profile si pjese e shkencës së financës. Në programin e studimit të detajuar, shohim se lëndët karakterizuese mbulojnë objektin e vete programit me fokus sektorin financiar publik dhe privat që në trendin e zhvillimit të tij rrit kërkesën për përdorimin e njohurive në këtë fushe.</p> <p><i>Evidence nr.2.Statuti i UET</i>  <i>Evidence nr.4.Plani strategjik për zhvillimin e programit të studimit MSH ne Financë me tre profile</i>  <i>Evidence nr.14.Kurrikula e programit mësimor MSH në Financë me tre profile</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ bazuar në dokumentacionin e ofruar nga institucioni si dhe vizitën e realizuar në institucion konkludon se program i studimit MSH në "Financë" me tre profile është në përputhje me misionin dhe qëllimin e veprimtarisë të UET duke ruajtur interesat dhe vlerat kombëtare.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>		<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

**Standardi I.2**

**Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>Organizimi i UET, struktura e tij hierarkike, eksperiencia relativisht e gjatë e institucionit, kapacitetet dhe burimet njerëzore të njësisë kryesore dhe baze ofrojnë garancinë për ofrimin e një programi MSH ne Financë me tre profile dhe përmbushjen e misionit dhe objektivave të tij. FEBZH si njësi kryesore dhe DEF që mbulon këtë program studimi, arrijnë që nëpërmjet kualifikimit të nevojshëm dhe kapaciteteve akademike që ato kanë, të realizojnë me sukses zhvillimin e programit.</p> <p><b>Referuar tabelës1.1 për stafin akademik të FEBZH si njësi kryesore e programit të studimit rezultoi se kjo njësi në vitin akademik 2022-</b></p>



	<p>2023 ka në përbërje të saj 3(tre) departamente me 27 PAE dhe 15 PAK. Të tre departamentet plotësojnë kriterin e numrit të PAE.</p> <p>Rezulton se institucioni ka përvojën dhe burimet për ofrimin e një programi MSH në “Financë” me të tre profilet e tij.</p> <p><b>DEF si njësi bazë e programit të studimit të MSH në “Financë”</b> bazuar në tabelën nr 1, 2 të RVB gjatë 3 viteve të fundit akademike ka pasur një numër të qëndrueshëm staf akademik që përbëhet si me poshtë:</p> <table border="1" data-bbox="555 658 1401 779"> <thead> <tr> <th>2020-2021</th> <th>2021-2022</th> <th>2022-2023</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>(18 PA)</td> <td>(15PA)</td> <td>(15PA)</td> </tr> <tr> <td>14 PAE / 4 PAK</td> <td>13 PAE / 2 PAK</td> <td>10 PAE / 5 PAK</td> </tr> </tbody> </table> <p><i>Evidencë Aneks tabelat përmbledhëse . Tabela nr.1.1; 1.2; 2.1.dhe 2.3. në RVB</i></p>	2020-2021	2021-2022	2022-2023	(18 PA)	(15PA)	(15PA)	14 PAE / 4 PAK	13 PAE / 2 PAK	10 PAE / 5 PAK
2020-2021	2021-2022	2022-2023								
(18 PA)	(15PA)	(15PA)								
14 PAE / 4 PAK	13 PAE / 2 PAK	10 PAE / 5 PAK								
<p><b>Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</b></p>	<p>Bazuar në rregullores së FEBZH, rregulloren e DEF si dhe rregulloren e këtij programi studimi vihet re se ky ofrimi i këtij programi me fushën e përgjithshme të ekonomisë që është fokus i njësisë kryesore dhe financës që është fokus i njësisë baze.</p> <p>Bazuar ne CV-te e personelit akademik (PAE dhe PAK) që zhvillon këtë program konstatojmë se profili i tyre akademik dhe fusha e kërkimit shkencor përkojnë me fokusin e programit MSH ne Financë.</p> <p>Bazuar edhe ne Programin e madh kërkimor të UET 2020-2025 nga takimi me personelin akademik të programit konstatuam angazhim serioz të tyre ne projekte kërkimore shkencore ne fushën e financës.</p> <p>DEF ne funksion të këtij qëllimi është i organizuar në 3 Grupe Kërkimore Shkencore të me fokus sektorin financiar por për të tre komponentët e tij.</p> <p>Programet e studimit ne FEBZH organizohen në dy nivele edhe ne fushën e financës duke synuar të sigurojë njohuri të krahasueshme me institutet analoge universitare jashtë vendit.</p> <p><i>Evidencë nr.5 .Rregullore e UET</i>  <i>Evidencë nr.7.1.Rregullore e programit MSH ne Financë</i>  <i>Evidencë Aneks tabelat përmbledhëse . Tabela nr.1.1; 1.2; 2.1.dhe 2.3. në RVB</i>  <i>Evidence nr.20. CV e stafit akademik</i></p>									



<p><b>Kriteri 3.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p>	<p>Bazuar në planin strategjik të UET 2021-2025, tek pika II Kërkimi Shkencor theksohet: “<i>UET vlerëson se fushat dhe drejtimet kryesore të kërkimit shkencor duhet të jenë në të njëjtën linjë me vetprofilin akademik e shkencor të UET, duke u përqendruar në drejtime të tilla si: ekonomia, financat, administrimi, edukimi, etj.</i>” Referuar gjithashtu mënyrës së organizimit të departamentit në ne funksion të kërkimit shkencor në tri grupe kërkimore shkencore konkludojmë se fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit MSH në “Financë” është në përputhje me fushën akademikee kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit qe është DEF si njësi përgjegjëse për zhvillimin e këtij programi.</p> <p><i>Evidencë nr.3. Plani Strategjik i UET 2021-2025</i>  <i>Evidencë nr.7.1.Rregullore e programit MSH ne Financë</i>  <i>Evidencë Aneks tabelat përmbledhëse . Tabela nr.1.1; 1.2; 2.1.dhe 2.3. në RVB</i>  <i>Evidence nr.20. CV e stafit akademik</i></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Në rastet kur institucioni ofron program “Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohet nga institucionet partnere.</p>	<p>Nuk aplikohet</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtijshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.</p>	<p>Nuk aplikohet</p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ bazuar në dokumentacionin e ofruar nga institucioni si dhe vizitën e realizuar në institucion konkludon se program i studimit MSH në “Financë” me tre profile është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe baze per programin e studimit ne UET.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht <b>X</b></p>



**Standardi I.3**

**Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisë profesionale, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësisë përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Marrëdhëniet e bashkëpunimit brenda UET dhe ndarja e detyrave dhe përgjegjësisë mes njësisë kryesore, njësisë baze dhe gjithë strukturave mbështetëse të programit janë të sanksionuar në një sere aktesh rregullative dhe mbikëqyrëse, si statutin, rregullore e UET, rregullore e programit të studimit MSH ne Financë dhe në procedura ne funksion të këtij qëllimi. Po ashtu janë një sere aktesh të tjera qe disiplinojnë punën e dekanatit, departamentit, sekretarisë mësimore, zyrës se burimeve njerëzore apo hallkave të ndryshme të institucionit ne të cilat përcaktohen rolet, funksionet dhe ndarja e përgjegjësisë e tyre të cilat i shërbejnë mbarëvajtjes se programit të studimit.</p> <p><i>Evidence nr.2.Statuti i UET</i>  <i>Evidencë nr.5 .Rregullore e UET</i>  <i>Evidence nr.6.Dokument mbi organizimin dhe funksionimin e Dekanatit dhe Departamentit</i>  <i>Evidencë nr.7.1.Rregullore e programit MSH ne Financë</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendas dhe/ose të huaj.</p>	<p>Në funksion të realizimit të objektivave mësimore dhe formuese të studenteve UET ka nënshkruar një nume të larte marrëveshje bashkëpunimi me 154 institucione brenda vendit dhe 94 homologe të tij jashtë vendit , 15 institucione homologe brenda vendit si dhe me 47 aktore të biznesit si një kompletim i projektit 500 + që funksionon prej vitesh. Në funksion të programit MSH në Financë janë realizuar marrëveshje bashkëpunimi me një numër institucionesh financiare ( banka dhe shoqëri siguri) të cilat përbejnë dhe pjesën me të madhe të tregut të punës në këtë fushe.</p> <p>Këto marrëveshje bashkëpunimi janë realizuar kryesisht nëpërmjet projekteve të përbashkëta si Tempus, ERASMUS + ; IPA etj. Këto marrëveshje përfshijnë shkëmbime reciproke të vizitave akademike shkencore si dhe marrëdhënie të tjera reciproke në fushën e kualifikimit, shkëmbimit të eksperiencave, realizimit të praktikave mësimore etj.</p>

<p><b>Kriteri 3.</b> Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p><i>Evidence nr. 34. Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit</i></p> <p>Nga shqyrtimi i dosjes së përcjellë dhe evidentimit gjatë vizitës në institucion, konstatohet se UET ka një sërë marrëveshjesh me institucione dhe sipërmarrje në funksion të realizimit të praktikës profesionale. Gjatë takimeve në FEBZH, pedagogët u shprehën, por dhe studentët konfirmuan që pedagogët kontribuojnë në punësimin apo intershipet e tyre, përmes ndarjes së informacionit në auditor dhe mbështetjes në karrierën të tyre.</p> <p>Veçori pozitive e këtij program është realizimi i praktikave /intershipeve të studenteve pjesërisht pranë institucioneve financiare , sipërmarrjeve të ndryshme etj dhe pjesërisht ne vete institucionin e sanksionuar kjo ne program gjate semestrave të zhvillimit të programit.</p> <p><i>Evidence nr.32. Lista e subjekteve dhe institucioneve bashkëpunuese për programin e studimit dhe praktikat profesionale</i>  <i>Evidence nr. 14. Kurrikula e programit të studimit.</i></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.</p>	<p>Departamenti i Ekonomiksit dhe Financës si njësi baze dhe përgjegjëse e këtij program evidenton nëpërmjet raporteve periodike përfitimet nga marrëveshjet e bashkëpunimit që ka institucioni me të tretet në evidentuam në raportin periodik të prezantuar në aplikim ku trajtoheshin rezultatet e bashkëpunimit nëpërmjet të dhënave të shkëmbimeve të studenteve dhe stafeve në kuadër të marrëveshjeve me institucione homologe jashtë vendit, realizimin e intershipeve dhe praktikave profesionale të studenteve pranë institucioneve dhe bizneseve vendase si dhe rezultatet e panairit të punës që organizon institucioni.</p> <p><i>Evidence nr. 52. Raporti i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ bazuar në dokumentacionin e ofruar nga institucioni si dhe vizitën e realizuar në institucion konkludon se program i studimit MSH në "Finance" bazohet në një numër të konsiderueshëm marrëveshjesh bashkëpunimi mes UET dhe institucioneve apo sipërmarrjeve të ndryshme duke mundur realizimin e praktikës profesionale dhe marrjen e eksperiencës nga specialiste të fushës jashtë institucionit..</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)



				<b>X</b>
--	--	--	--	----------

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË

<b>Standardi II.1</b>	
<b>Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Programi i studimit MSH në “Financë” me tre profilet është bazuar në plotësimin e kërkesave ligjore dhe rregullative në fuqi si dhe në përputhje me VKM Nr. 41, datë 21.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar, ku lëndët e modulet vlerësohen me sistemin e krediteve ECTS dhe orë, me një total 120 kredite në dy vitet, 4 semestra dhe me ngarkesë studenti 25 orë në javë. Duke shqyrtuar planin mësimor të këtij programi studimi, konstatohet që numri i krediteve për lende është i ndryshëm nga 6 , 8 apo 10 kredite duke reflektuar ngarkesën (angazhimit) në auditor dhe jashtë tij të studentit qe logjikisht mund të ndryshojë për lende të veçanta.</p> <p><i>Evidencë nr.5.Rregullore e UET</i>  <i>Evidencë nr.7.1.Rregullore e programit MSH ne Financë</i>  <i>Evidence nr.14. Kurrikula e programit MSH ne Financë</i>  <i>Evidence nr.14.2.Plani mësimor i programit</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit synon formimin e shprehive</p>	<p>Nga shqyrtimi i programit mësimor si dhe përmbajtjes së syllabuseve konstatohet që arrihet të transmetohen njohuri të</p>





të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparura në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparura në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.

fushës së financës, aplikimit praktik të programeve financiare dhe ekonometrike duke përbushur dhe objektivat e një programi Master Shkencor. Kjo bën të mundur që studentët që përfundojnë këtë program mund të punësohen si specialistë të financës, riskut dhe të kontabilitetit pranë institucioneve financiare apo sipërmarrjeve private si dhe në sektorin publik të analizës ekonomike.

Përmirësimet në këtë program janë rrjedhojë e kalimit nga 5 profile në 3 profile të riemërtuara si dhe të ndryshimeve në kurrikulen të realizuara në vitin 2022 të cilat kanë ri dimensionuar vetë programin dhe orientuar atë drejt tregut të punës. Nga ana tjetër një numër lëndesh të programit janë të nivelit shkencor dhe kërkues që bëjnë të mundur që studentet të aftësohen edhe në realizimin e punimeve shkencore nëpërmjet analizave dhe përdorimit të metodave bashkëkohore.

*Në këndvështrimin e përmirësimit të mundshëm të programit mendojmë se:*

- *Një përfshirje më e mirë e lëndëve në kuadër të profileve do i shërbejë me mirë arritjes së qëllimit të vetë programit. Në funksion të këtij qëllimi mendojmë se lëndët me zgjedhje që janë dhe përcaktuese të 3 profileve duhet të jenë me të larmishme.*

*Së pari; të mund të ofroheshin në semestrat përkatëse 3 lënde me zgjedhje aq sa janë edhe profilet nga 2 të tilla që janë aktualisht.*

*Së dyti; Në profilin "Banke dhe Tregjet Financiare" të shihet mundësia që në lëndët me zgjedhje të përfshihen lëndë me fokus financën të tilla si "Drejtimit Portofoli", apo Vendimmarrja Financiare" duke përmirësuar profilin përkatës.*

- *Duke u bazuar tek programi mësimor Bachelor në Finance që aktualisht zhvillohet në FEBZH në të cilin zhvillohen lënda "Tregjet financiare" e cila ka mbivendosje me lëndën "Tregjet e kapitalit" dhe institucionet financiare" të programit të studimit. Gjithashtu dhe lënda "E drejte Bankare", e programit Bachelor është në këtë program si lënde me zgjedhje.*

*Evidence nr.14. Kurrikula e programit MSH në Financë*



	<i>Evidence nr.14.2.Plani mësimor i programit</i>
<b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.	<p>Programi i studimeve Master i Shkencave në “Financë”, në përputhje me vendimin nr. 41, datë 24.1.2018, “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga IAL”, ka përcaktuar ngarkesën në kredite për praktikën profesionale dhe detyrimet përmbyllëse. Parashikohen 12 kredite për praktikën profesionale ose 300 orë gjithsej, nga të cilat 248 orë në auditor dhe 52 orë punë e pavarur nga studentët. Për detyrimet përmbyllëse parashikohen 18 kredite ose 450 orë gjithsej, nga të cilat 36 orë në auditor dhe 414 orë punë e pavarur nga studentët. Mbrojtja e diplomës është detyrimi përfundimtar për diplomimin e studentit. Bazuar në programin e studimit shikojmë si risi zhvillimin e praktikës profesionale dhe angazhimit të punimit të diplomës që në semestrin e parë dhe gjatë zhvillimit të programit. Kjo duhet konsideruar me eficientë pasi nëpërmjet praktikës dhe angazhimit gjatë gjithë periudhës së zhvillimit të programit, studenti aplikon njohuritë e marra në lëndët metodologjike shkencore dhe ato karakterizuese duke shpërndarë kështu ngarkesën e studenteve në kohe.</p> <p><i>Evidence nr.14. Kurrikula e programit MSH ne Financë</i> <i>Evidence nr.14.2.Plani mësimor i programit</i></p>
<b>Kriteri 4.</b> Programet e ciklit të dytë “Master” në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësim i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve “Master”, sipas fushave përkatëse të formimit.	<b>Nuk aplikohet</b>
<b>Kriteri 5.</b> Programet “Master” në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të	<b>Nuk aplikohet</b>

<p>përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet “Master”, që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.</p>	
<p><b>Kriteri 6.</b> Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>Bazuar në Statutin e UET, dokumentacionin e aplikimit pranë ASAL-it si dhe nga vizita në institucion, GVJ vlerësojmë se forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi i veprimtarisë akademike kërkimore shkencore realizohet në përputhje me ligjin e arsimit të lartë të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë së arsimit.</p> <p><i>Evidence nr.2.Statuti i UET</i>  <i>Evidence nr.14. Kurrikula e programit MSH ne Financë</i>  <i>Evidence nr.14.2.Plani mësimor i programit</i></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.</p>	<p>Bazuar në planin mësimor të programit vërejmë se ai ka përmbajtje të ngjashme në nivel rreth 70 për qind, me programe të tjera ofruar nga institucione të arsimit të lartë në Shqipëri dhe që kanë të njëjtën/pothuajse emërtesë.</p> <p>FEBZH dhe DEF aktualisht ofrojnë vetëm këtë program studimi MSH ne Financë.</p> <p><i>Evidence nr.14. Kurrikula e programit MSH ne Financë</i>  <i>Evidence nr.14.2.Plani mësimor i programit</i>  <i>Evidence Tabelat përmbledhëse nr.3</i></p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.</p>	<p>Sipas RVB-së, UET ka aplikuar në Ministrinë e Arsimit përsa i përket kodit përkatës sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve për programin e studimit Master i Shkencave në “Finance” me 3 profile.</p> <p><i>Evidence nr.31.3. Shkresë e UET; Propozimet për kodifikimin e programeve të studimit</i></p>
<p><b>Kriteri 9.</b> Programet e studimit mund të jenë edhe</p>	<p>Bazuar në rregulloren e programit të studimit programi Master i Shkencave në “Financë” me 3 profilet nuk është program i</p>

programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	përbashkët midis IAL-ve, jashtë apo brenda vendit por realizohet nga UET			
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ bazuar në dokumentacionin e ofruar nga institucioni si dhe vizitën e realizuar në institucion konkludon se program i studimit MSH në "Financë" me 3 profilet organizohet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi në strukturë dhe përmbajtje. Megjithatë në funksion të përmirësimit të tij sugjerimet e mësipërme të GVJ lidhur me këtë program studimi do e përmirësonim më tej atë në drejtim të konsolidimit të profileve .</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

### Standardi II.2

**Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>			
<b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	<p>FEBZH si njësi kryesore përgjegjëse e programit MSH në "Financë me 3 profile përmbush detyrimet ligjore lidhur me strukturën akademike dhe stafet akademike për zhvillimin e këtij program. Në viti akademik <b>2022-2023</b> FEBZH përfshin në strukturën <b>42</b> anëtarë si personel akademik nga të cilët <b>27</b> anëtarë janë PAE dhe <b>15</b> anëtarë janë PAK, që janë pjese e tre Departamenteve :</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut;</li> <li>2. Departamenti i Ekonomiksit dhe Financës;</li> <li>3. Qendra për Zhvillimin e Qëndrueshëm</li> </ol>			
<b>Cilësia e stafit Fakulteti i Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit (Tabelat përmbledhëse: Tabelat 1)</b>				
	2021-2022		2022-2023	
	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr	3	1	4	
Prof.Asoc.	4		2	1

Dr	15	3	16	9
Msc	9		5	5
<b>Gjithsej</b>	<b>31</b>	<b>4</b>	<b>27</b>	<b>15</b>

Raporti personel akademik efektiv/studentë në nivel **njësie kryesore** FEBZH për vitin akademik **2022-2023** është 1 pedagog me 28 studentë

Bazuar në dokumentacionin e aplikimit nga institucioni shikojmë se gjate 3 viteve të fundit DEF si njësi baze përgjegjëse e programit plotëson kërkesat ligjore dhe nënligjore lidhur me strukturën akademike dhe stafin akademik duke pasur një numër të qëndrueshëm stafi.

Në vitin akademik **2022-2023** nga **15** anëtarë stafi akademik të kësaj njësie, **10** janë PAE nga ( nga të cilët 1 Prof. Dr., 2 Prof. Asoc. Dr., 2 Dr., 3 Doktorantë dhe 2 MSc ) dhe **5** janë PAK ( nga të cilët 3 Dr. dhe 2 MSc )

<b>Cilësia e stafit të Departamentit të Ekonomiksitë dhe Financës, (Tabelat përmbledhëse: Tabelat 2.4/2.5)</b>				
Titulli/Grada	2021-2022		2022-2023	
	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr	1		1	
Prof.Asoc.	3		2	
Dr	6	1	5	3
Msc	3	1	2	2
<b>Gjithsej</b>	<b>13</b>	<b>2</b>	<b>10</b>	<b>5</b>

*Evidence . Tabelat përmbledhëse të RVB, nr.2.2 dhe 1.2.*

**Kriteri 2.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave

Praktika profesionale e studentëve organizohet, ndiqet dhe mbikëqyret nga DEF përgjegjëse për programin e studimit dhe në bashkëpunim me Zyrën e Këshillimit të Karrierës. Departamenti cakton një pedagog i cili është përgjegjës për zhvillimin e seancave të zhvillimit profesional dhe karrierës në auditor.

Gjithashtu institucioni ka personel ndihmës akademik në realizimin e punëve laboratorike apo në ndihme të procesit mësimor që në strukturën e paraqitur janë në nivel institucional.

*Evidence . Tabelat përmbledhëse të RVB, nr.8.*

mësimore, laboratorike e klinike, etj.									
<b>Kriteri 3.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	GVJ bazuar në vizitën realizuar në UET dhe dosjen e aplikimit , konfirmon se DEF si njësi bazë përgjegjëse për programin e studimit Master i Shkencave në “Finance ” me 3 profile ka caktuar një person si koordinator programi i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në auditor si edhe për ndjekjen e praktikave ne institucione apo njësi të tjera ekonomike.  <i>Evidence nr.36. Vendimi për emërimin e koordinatorit të programit të studimit MSH ne “Financë”</i> <b>Vizita ne institucion</b>								
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ, shpreh se njësia kryesore FEBZH dhe ajo bazë DEF përgjegjëse për programin e studimit përmbushin kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.</i>								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <tr> <td>Nuk përmbushet</td> <td>Përmbushet pjesërisht</td> <td>Përmbushet kryesisht</td> <td>Përmbushet plotësisht</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

### Standardi II.3

**Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Bazuar në dokumentacionin e aplikimit si dhe në vizitën e realizuar në institucion GVJ evidenton se FEBZH si njësi kryesore dhe DEF si njësi baze e programit kanë informacionin e plotë mbi organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e këtij program. Stafi akademik në këto njësi njih rregulloren e këtij program, planin mësimor dhe përmbajtjen e programit të lendeve përkatëse që zhvillohen. Diskutimi në departament dhe axhustimi i bërë vitin e kaluar në këtë program i ka shërbyer më mirë këtij qëllimi. Informacion rreth programit gjendet dhe në sistemin LMS dhe faqen e internetit të institucionit.  <i>Evidence nr.7. Rregullore e programit të studimit MSH në Financë.</i> <i>Evidence nr. 14.2. Plani mësimor i programit.</i> <i>Evidencë nr.19. Syllabuset e lendeve të programit MSH në Financë</i>

<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestral, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.</p>	<p><i>Vizita ne institucion: Takim me stafin akademik</i></p> <p>GVJ evidentoi dhe shqyrtoj evidenca të planeve mësimore, rregulloren e programit të studimit Master i Shkencave në “Financë”, syllabuset e lëndëve ku përfshihet informacioni i plotë për ndarjen e lëndëve në semestrale, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor si leksionet ashtu edhe seminarët, orët jashtë auditorit si puna e pavarur, si dhe të gjithë komponentët formues të programit, duke respektuar VKM nr.41.date 24.01.2008 “Për elementët e programeve të studimit’ e ndryshuar “</p> <p><i>Evidence nr.7. Rregullore e programit të studimit MSH në Financë.</i>  <i>Evidence nr. 14.2. Plani mësimor i programit.</i>  <i>Evidencë nr.19. Syllabuset e lendeve të programit MSH në Financë</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Programi i studimit ofron të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve. Studentët nëpërmjet planit mësimor dhe kuadrit rregullator të brendshëm ( rregulloret e studimit në rang institucional, njësi kryesore/bazë, dhe nivel programi kanë informacionin e duhur që në procesin e pranimit , regjistrimit dhe zhvillimit të programit ashtu edhe procedurat e transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p> <p><i>Evidence nr.2 Statuti UET, Neni 32,</i>  <i>Evidence nr.7Rregullore e programit të studimit MSH në Financë, pika 5 dhe 6</i>  <i>Evidencenr.14.2. Plani mësimor i programit MSH në Financë</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikant, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Duke shqyrtuar programet e lendeve (syllabuset) vërejmë se ato janë ndërtuar ne zbatim të VKM nr.41.date 24.01.2008 “Për elementët e programeve të studimit’ e ndryshuar, si ne strukture dhe përmbajtje ku përfshihen:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Emërtimi i lëndës/modulet</li> <li>• Viti/semestri kur zhvillohet lënda</li> <li>• Emri i pedagogut që do të zhvillojë lëndën</li> <li>• Vendi që zë lënda në formimin tërësor të studentit</li> <li>• Njohuritë paraprake që duhet të ketë studenti për përvetimin e lëndës</li> <li>• Çfarë njohurish dhe aftësish i jep studentit kjo lëndë</li> </ul>



	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Temat që do të trajtojnë lënda në formimin teorik dhe praktik</li> <li>• Ngarkesa në orë në auditor dhe jashtë auditorit si dhe në ECTS</li> <li>• Format dhe metodat e mësimdhënies të lëndës dhe raportet midis tyre</li> <li>• Format e vlerësimit të studentëve</li> <li>• Detyrimet e studentit për lëndën</li> <li>• Literatura e detyruar dhe ajo ndihmëse</li> </ul> <p>Format e vlerësimit të mësimdhënies janë nëpërmjet vlerësimit periodik në seminare (për pjesëmarrje aktive), detyra kursi, provime të ndërmjetme dhe provim final. Përkatësisht, studenti vlerësohet në kufijtë 40% deri 60 % nga elementet gjate vitit dhe 40% deri 60% nga provimi përfundimtar.</p> <p>Në fillim të do viti kalendarik stafi akademik harton edhe programin e lëndës që zhvillon në program e cila depozitohet në Departament. Një numër i limituar i syllabusve kishin literature relativisht jo të viteve të fundit. Gjithashtu, nga shqyrtimi i dokumentacionit u vërejt se mungonin dy programe lëndore të cilat gjate vizitës ne institucion ju kërkuan drejtuesve të njësisë kryesore/baze. Institucioni përmbushi këtë mangësi duke dërguar si pjese e dokumentacionit shtese të kërkuar edhe këto dy syllabuse.</p> <p><i>Evidence nr. 14.2. Plani mësimor i programit.</i>  <i>Evidencë nr.19. Syllabuset e lendeve të programit MSH në Financë</i>  <i>Vizita ne institucion: Takim me stafin akademik</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e aplikimit të institucionit pranë ASCAL-it si dhe vizitën e GVJ në ambientet e UET konfirmojmë se gjate viteve të fundit është diskutuar mundësia e përmirësimeve në program. Si rrjedhoje në vitin e kaluar janë bërë ndryshime në program poshtë nivelit 20 % të krediteve si dhe aplikimi përfshin 3 profile nga 5 të tilla që ka pasur ky program që në akreditimin e fundit.</p> <p><i>Tabelat aneks të RVB. Tabela nr.11</i>  <i>Vizita ne institucion: Takim me stafin akademik</i></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Programi i studimit MSH ne me 3 profile është i strukturuar dhe organizuar në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullativ në fuqi</i></p>



	<i>si dhe me objektivat formuese të këtij programi. Përsa i përket këtij standartit II.3, GVJ shprehet se përmbushet plotësisht.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

#### **Standardi II.4**

**Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	<p>Nga shqyrtimi i programit shohim që në përmbajtjen e tij ai ofron tiparet e një programi të nivelit të dytë në fushën e Financës. Programi ndërtohet mbi njohuritë e fituara në ciklin e parë të studimit dhe thellon njohuritë dhe aftësitë e studentëve në përputhje me kriteret e vendosura. Këtë e shikojmë në përmbajtjen e lëndëve të programit ku është bërë një gërshetim mes njohurive teoriko shkencore me ato aplikative dhe të kombinuara me realizimin e praktikës profesionale. Kjo jep mundësi punësimi në tregun e punës kryesisht të sektorit financiar e bankar. Në program dominojnë lëndet e fokusuar në objektin e tij që është finance kontabilitetit.</p> <p><i>Evidence nr.7.Rregullore e programit të studimit MSH në Financë, Evidencenr.14.2. Plani mësimor i programit MSH në Financë</i></p>
<b>Kriteri 2.</b> Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor.	<p>Programi arrin të pajisë studentët krahas njohurive të përgjithshme dhe specifike në fushën e riskut dhe menaxhimit e tij edhe mundësinë për të realizuar kërkime shkencorë në sektorë të veçante të cilat ballafaqohen me natyra të ndryshme të finance, kontabilitetit dhe riskut. Nga ana tjetër, programi arrin të rrisë edhe kompetencat profesionale të studentëve me fokus rritjen e aftësive aplikative që përfshijnë fushën e analizës dhe modelimit të riskut.</p> <p>Mbështetur në 14 lëndët që ofron programi, por edhe në praktikën/intershipin të përfshirë në të, ai arrin të ketë objektiv formimin teorik shkencor dhe relativisht edhe atë aplikativ të studentëve. Në këtë kuadër praktika dhe përgatitja e mikrotezës që</p>

	<p>synohet të jetë aplikative, i shërbejnë këtij objektivit në rritjen më shumë të përgatitjes profesionale të studentëve.</p> <p><i>Evidencë nr. 14.2. Plani mësimor i programit.</i>  <i>Evidencë nr.19. Syllabuset e lendeve të programit MSH në Financë</i></p>																		
<p><b>Kriteri 3.</b> Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit “Master Profesional”, ky program duhet të sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.</p>	<p>Programi në hartimin dhe zhvillimin e tij bazohet në eksperiencat bashkëkohore Europiane dhe të vendit, si edhe duke vlerësuar nevojat e tregut të punës për specialiste në fushën e financës. Mbështetur në strukturën e programit, në lëndët që përfshihen në të, raportet teorike praktike, ky program përputhet me drejtimin e zgjedhur që është financa me 3 profilet përkatëse si nën fusha të financës. Në të arrihet të trajtohen elementët e nevojshëm që lehtësojnë njohjen dhe ekuivalentimin e diplomës jashtë vendit, për qëllim vazhdimin e studimeve apo punësimit të studentit. Programi i studimit është në përputhje me objektivat e përcaktuara në legjisllacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara. në kuadër edhe të projektit të përbashkët në hartimin e këtij programi është bashkëpunuar edhe me universitetet analoge të disa prej vendeve të BE. Zhvillimi i këtij programi studimi është bazuar edhe në një studim tregu me operatorët kryesor të tij nëpërmjet intervistave dhe pyetësorëve të fokusuar në objektin e programit.</p> <p><i>Evidencë nr. 14.2. Plani mësimor i programit.</i>  <i>Evidencë nr.19. Syllabuset e lendeve të programit MSH në Financë</i></p>																		
<p><b>Kriteri 4.</b> Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Ky program studimi përmban të gjithë elementët e përcaktuar në Ligjin 80/2015 dhe VKM Nr.41, datë 24.01.2018. i ndryshuar. Veprimtaritë formuese kanë një shpërndarje si në tabelën më poshtë:</p> <table border="1" data-bbox="587 1485 1401 1888"> <thead> <tr> <th rowspan="2">Kategoria /</th> <th rowspan="2">Përqindja Krediteve Sipas VKM</th> <th colspan="2">Programi Msc. MR</th> </tr> <tr> <th>Kredite</th> <th>Përqindje</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>A. LËNDË BAZË</td> <td>5%-10%</td> <td>12</td> <td>10%</td> </tr> <tr> <td>B. LËNDË KARAKTERIZUESE</td> <td>50%- 60%</td> <td>60</td> <td>50%</td> </tr> <tr> <td>C. LËNDË NDËRDISIPLINORE</td> <td>12%-20%</td> <td>18</td> <td>15%</td> </tr> </tbody> </table>	Kategoria /	Përqindja Krediteve Sipas VKM	Programi Msc. MR		Kredite	Përqindje	A. LËNDË BAZË	5%-10%	12	10%	B. LËNDË KARAKTERIZUESE	50%- 60%	60	50%	C. LËNDË NDËRDISIPLINORE	12%-20%	18	15%
Kategoria /	Përqindja Krediteve Sipas VKM			Programi Msc. MR															
		Kredite	Përqindje																
A. LËNDË BAZË	5%-10%	12	10%																
B. LËNDË KARAKTERIZUESE	50%- 60%	60	50%																
C. LËNDË NDËRDISIPLINORE	12%-20%	18	15%																



	D. LËNDË PLOTËSUESE (Praktika)	10%	12	10%
	E. DETYRIME PËRMBYLLËSE	10%- 15%	18	15%
<p><b>Kriteri 5.</b> Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.</p>	<p>Vlerësojmë se përmbushen kriteret e kategorizimit të lendeve të programit.</p> <p>Duke analizuar planin mësimor dhe programin mësimor të prezantuar në aplikimin e institucionit si dhe nga bashkëbisedimi me stafin që mbulon këtë program vërejmë se ka një raport të drejtë mes formimit teorik dhe atij praktik të studenteve që kanë preferuar të jenë menaxhere të riskut në sektorët real dhe financiar. Pa dashur të përsërisim strukturën e programit të trajtuar me lart shohim që ka harmonizim të trajtimeve teorike në lendet e formimit të përgjithshëm me grupin dominues të lendeve të formimit profesional. Nga shqyrtimi i programeve të lendeve shikojmë se në to kemi si trajtime teorike të avancuara ashtu edhe aplikime të metodave të drejtimit të riskut. Trajtimi i rasteve studimore, punëve laboratorike dhe realizimit të praktikës mësimore harmonizon realizimin e objektivave të këtij program.</p> <p><i>Evidenca nr.14.4. Plani mësimor i ndare sipas veprimtarive formuese</i></p> <p><i>Evidenca nr.14.3. Plani mësimor i programit</i></p> <p><i>Evidenca nr.19. Syllabuset e lendeve të programit.</i></p> <p>Nga shqyrtimi i programeve të lendeve si dhe nga takimi me stafin në institucion evidentohet përmbajtja cilësore e të gjithë elementeve të përcaktuar. Ky program ka një historik relativit të gjatë që po zhvillohet dhe që vitin e kaluar është përmirësuar në programe të disa lendeve (nen kufirin e 20 % të krediteve ) me qëllim përmirësimin e tyre por edhe si reflektim i zhvillimeve të fundit të tregut financiar.</p> <p><i>Evidenca nr.14.3. Plani mësimor i programit</i></p> <p><i>Evidenca nr.19. Syllabuset e lendeve të programit.</i></p> <p><i>Evidenca: Tabelat anekse të RVB. (tabela nr.11)</i></p>			

<p><b>Kriteri 6.</b> Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.</p>	<p>Programi MSH në “ Financë” me profile i pajis studentët që zotërojnë tashmë një diplomë Bachelor në fushën e ekonomisë dhe financës, me njohuri më të thelluara teorike dhe praktike të fushës së menaxhimit të riskut. Gjithashtu, ky program u jep mundësi studentëve që mbarojnë studimet, të specializohen me njohuri të avancuara të përdorimit të teknikave të vlerësimit dhe menaxhimit të risqeve në sektorin financiar, kryesisht privat, si dhe në sektorët e tjerë të ndikuar nga risqet të natyrave të tjera. Kjo u jep më shumë mundësi në tregun e punës, sidomos në sektorin financiar dhe real të ekonomisë.</p> <p><i>Evidenca nr.14.4. Plani mësimor i ndare sipas veprimtarive formuese</i></p> <p><i>Evidenca nr.14.3. Plani mësimor i programit</i></p> <p><i>Evidenca nr.19. Syllabuset e lendeve të programit.</i></p>		
<p><b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Programi i studimit është mbështetur në eksperiencën e programeve të tilla kombëtare, por para se gjithash ato ndërkombëtare të universiteteve partnere të projekteve të përbashkëta. Gjithashtu, ky program u mundëson hyrjen në tregun e punës të studentëve jo vetëm në segmentin e sektorit financiar e bankar por edhe pranë institucioneve që mbulojnë sektorë reale të ekonomisë apo instituteve monitoruese të tregjeve të sektorëve të tjerë.</p> <p><i>Evidenca nr.14.4. Plani mësimor i ndare sipas veprimtarive formuese</i></p> <p><i>Evidenca nr.14.3. Plani mësimor i programit</i></p> <p><i>Evidenca nr.19. Syllabuset e lendeve të programit.</i></p>		
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Struktura dhe organizimi i programit janë në përputhje me objektivat formuese dhe kualifikimin sipas Kuadrit Kombëtar dhe Europian të Kualifikimit dhe në përputhje me kërkesat e tregut të punës.. Përsa i përket këtij standardi II.4, GVJ shprehet se përmbushet plotësisht</i></p>		
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>



**Standardi II.5**

**Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.</p>	<p>FEBZH si njësi kryesore dhe DEF si njësi bazë dhe përgjegjëse e këtij programi bazuar në marrëveshjet institucionale me aktorët e tregut të punës analizojnë periodikisht mundësitë e përmirësimit të programeve ku ajo është përgjegjëse drejtpërdrejt. Lidhur me këtë program ashtu siç edhe e kemi përmendur edhe me lart, përmirësimet kanë qënë kryesisht krahas mundësisë se lirisë akademike të stafit edhe në ndryshime në program të realizuara vitin e kaluar brenda kriterit 20% që përcaktojnë aktet ligjore dhe rregullative. Nga diskutimi me stafin akademik që zhvillon këtë program evidentuam përmirësim në ciklet e leksioneve të lëndëve që ata mbulojnë kryesisht me trajtime aplikative të lidhura me tregun financiar dhe pasuritë e paluajtshme. Një aspekt i rëndësishëm në këtë drejtim është edhe konsultimi me bordet e tregut të punës si dhe studimi i këtij tregu nga institucioni si një premise e rëndësishme për përmirësim në programin e studimit . Bazuar në tabelën nr.23 të anekseve të RVB shohim që në këtë program janë punësuar rreth 50 % të te diplomuarve.</p> <p><i>Evidence nr.17. Studim për tregun e punës</i>  <i>Evidencë nr.12.1.Bordi i tregut të punës</i>  <i>Evidenca nr.14.4. Plani mësimor i ndare sipas veprimtarive formuese</i></p> <p><i>Tabelat anekse të RVB. Tabela nr.23.</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>Bazuar vizitës në UET nga takimi me studentët, Këshillit studentor dhe pjesëtarë të Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe kujdesit ndaj studentit, si edhe nga rregullorja e kësaj zyre rezulton se institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, Bordin e Tregut të Punës për përmirësimin e programit të studimit të masterit shkencor në “Financë” me 3 profile. Po ashtu edhe DEF zhvillon diskutime me studente të këtij programi mbi përmirësimin të mundshme në program.</p> <p><i>Evidence nr.17. Studim për tregun e punës</i></p>

	<p><i>Evidencë nr.12.1.Bordi i tregut të punës</i>  <i>Evidence nr.12.6. Mbledhje e hapur e DEF.</i>  <i>Vizita e GVJ ne institucion; Takim me studentet dhe Zyrën e Këshillimit të Karrierës.</i></p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.</p>	<p>DEF mban kontakte periodike me studentet e programit, Zyrën e Këshillimit dhe Karrierës si dhe me Bordin e Tregut të punës në funksion të përmirësimit të programit dhe qasjes se tij me tregun e punës.</p> <p><i>Evidence nr.17. Studim për tregun e punës</i>  <i>Evidencë nr.12.1.Bordi i tregut të punës</i>  <i>Evidence nr.12.6. Mbledhje e hapur e DEF.</i>  <i>Vizita e GVJ ne institucion; Takim me studentet dhe Zyrën e Këshillimit të Karrierës.</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ evidenton përkushtim të FEBZH dhe FEF ne përmirësimin e programit të studimit ne baze të nevojave të tregut të punës dhe diskutimeve me vete studentet dhe aktore të tjerë ne këtë proces qe njohin mire nevojat e tregut financiar. Përsa i përket këtij standardi II.5, GVJ shprehet se përmbushet plotësisht.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

<p><b>Standardi II.6</b>  <b>Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.</p>	<p>Programi i studimit MSH ne “Financë” është i ndërtuar në përputhje me vizionin, misionin, objektivat e institucionit si dhe në strategjinë e kërkimit shkencor 2021-2025.</p> <p>Ky program studimi sipas rregullores së programit dhe akteve të tjera rregullative të institucionit ka si mision t’i pajisë studentët me një sistem bazë njohurish që i formon ata në fushën e financës, kontabilitetit dhe auditimit.</p> <p><i>Evidence nr. 2. Statuti i UET</i>  <i>Evidence nr. 3.1.Strategjia e kërkimit shkencor 2021-2025</i>  <i>Evidencë nr. 7. Rregullore e programit MSH ne “Finance”</i></p>

<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.</p>	<p>FEBZH dhe DEF bazuar ne statutin e UET bashkërendojnë procesin mësimor e shkencor të programeve të studimit përfshirë edhe këtë program. Gjatë vizitës në institucion në takimin me stafin e këtij programi u evidentua respektimi i lirisë akademike të përcaktuara në aktet nënligjore. Bazuar në nivelin dhe nevojat e studentëve, pedagogë të caktuar na argumentuan axhustime në program e lendeve përkatëse sidomos me zhvillimin e modeleve aplikative gjate trajtimit të projekteve të kursit apo përdorimin e modeleve ekonometrike në laborator.</p> <p><i>Evidence nr. 2. Statuti i UET</i>  <i>Vizita e GVJ ne institucion; Takim me drejtuesit e FEBZH, DEF dhe stafin akademik të programit.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.</p>	<p>Ky program studimi u jep mundësi studenteve të motivohen në përgatitjen e projekteve të kursit duke u dhënë atyre karakterin e një punimi teorike shkencore por edhe dhe aplikativ. Menaxhimi financiar i riskut, kontabiliteti dhe auditimi janë një fokus i gjere për ndërmarrjen e punimeve shkencore dhe aplikative. FEBZH dhe DEF tashme kanë një eksperience shumë vjeçare edhe në organizimin e eventeve të ndryshme me studentet duke u dhënë mundësi studenteve të përgatisin punime apo prezantime të fushës se financës. GVJ evidentoi pjesëmarrje të studenteve ne Konferencën e ditëve të Studimeve Shqiptare si dhe publikimi se bashku me pedagoget ne revistën e institucionit “Economius”.</p> <p><i>Evidence nr. 3.1.Strategjia e kërkimit shkencor 2021-2025</i>  <i>Vizita e GVJ në institucion; Takim me stafin akademik dhe studentet e programit</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.</p>	<p>Bazuar në statutin e UET, planin financiar për menaxhimin me efektivitet të institucionit si dhe pasqyrave financiare të institucionit, vihet re se, për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore ka mbështetje financiare nëpërmjet alokimit të fondeve ne fushat e kërkimit shkencor. DEF nuk vepron i veçuar financiarisht nga veprimtaria e UET dhe të gjitha aktivitet e ndryshme të zhvilluara mbështeten financiarisht nga institucioni nëpërmjet Zyrës se projekteve dhe Partneriteteve .</p> <p><i>Vizita e GVJ ne institucion; Takim me stafin akademik dhe pjesëtarë të zyrës se projekteve dhe partneriteteve .</i></p>

<b>Konkluzione</b>	<i>Përsa i përket këtij standardit II.6, GVJ shprehet se përmbushet plotësisht.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

### Standardi II.7

#### Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.	Strategjia e Kërkimit Shkencor 2021-2025 e hartuar nga institucioni përcakton qarte drejtimet në këtë fushë. Bazuar në evidencat përkatëse të dhënave të kërkimit shkencor, të dhënat e bashkëpunimeve shkencore në rang fakulteti si dhe nga raportin analitik të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit për realizimin e programit të masterit shkencor “Financë”, u evidentua se, FEBZH si njësi përgjegjëse mbështet projektet kërkimore-shkencore të reja si dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.  <i>Evidence nr. 3.1.Strategjia e kërkimit shkencor 2021-2025</i> <i>Evidence nr.55. Ditët e studimeve Shqiptare</i>
<b>Kriteri 2.</b> Njësia përgjegjëse angazhohet për t’iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.	Bazuar në strategjinë e kërkimit shkencor të institucionit si dhe në rregulloren e institucionit dhe atë të vete programit të studimit MSH në “Financë”, theksojmë se njësia përgjegjëse (FEBZG) dhe ajo baze (DEF), synojnë të angazhojnë stafin akademik dhe studentët në projekte dhe kërkime shkencore.  <i>Evidence nr. 3.1.Strategjia e kërkimit shkencor 2021-2025</i> <i>Evidence nr.55. Ditët e studimeve Shqiptare</i>
<b>Kriteri 3.</b> Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave.	FEBZH si njësi përgjegjëse në kuadër të Konferencës të Ditëve të Studimeve Shqiptare që organizohet në nivel institucional organizon dhe koordinon aktivizimin e stafit akademik të programit dhe të studenteve duke u mundësuar angazhim të tyre nëpërmjet prezantimeve në këtë eveniment të rëndësishëm. Edhe përfshirja e lektoreve të ftuar në prezantime të tyre me studentet i shërben me



	<p>mire realizimit të objektivave të vete programit. Kjo shihet edhe planifikimin që bën vete DEF.</p> <p><i>Evidence nr.55. Ditet e studimeve Shqiptare</i> <i>Evidence nr.56. Kalendari i aktiviteteve të DEF</i></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.</p>	<p>Referuar programit të studimit, përmbajtjes lendore si dhe tabelës nr.23 të punësimit të te diplomuarve ne këtë program rezulton se, njësia bazë nga ku buron programi studimit të masterit shkencor “Banka dhe Tregje Financiare”, formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar të punës.</p> <p><i>Evidence nr. 3.1.Strategjia e kërkimit shkencor 2021-2025</i> <i>Evidence nr.14. Kurrikula e programit MSH ne “Financë”</i></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rjetet profesionale, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës.</p>	<p>Nuk Aplikohet</p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian (p.sh. <i>Professional Qualifications Directive, 2005/36/EU</i>).</p>	<p>Nuk Aplikohet</p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ vlerëson se program i studimit garanton njohuri të thelluara ne financë si dhe mundësi kërkimi shkencor të suksesshëm duke permbushur plotësisht kete standard.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes sëstandardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

### III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

<b>Standardi III.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/ esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	<p>Mësimdhënia në programin MSH në “Financë” bazohet në rregulloren mësimore në nivel institucional, si dhe në rregulloren e këtij programi në të cilat përcakton format e mësimdhënies dhe vlerësimin e dijeve të studentëve. Procesi mësimor zhvillohet nëpërmjet formave të mirënjohura: leksione, seminare, detyra kurse, ushtrime, etj, të organizuara në 14 lëndë, ku janë parashikuar provime me shkrim, praktika dhe tema e diplomës. Lëndët klasifikohen vetëm si lëndë të detyruara.</p> <p>Në këtë program lëndët zhvillohen sipas syllabusit përkatës dhe në liri të plotë të personelit akademik. Për të ruajtur objektivitetin e vlerësimit forma e kontrollit në program është me shkrim dhe e sekretuar. Në politikën e Institucionit është praktikë që nota e studentit të jetë e “ndërtuar”, kjo do të thotë që studentit testohet gjatë semestrit në secilën lëndë përveç provimit përfundimtar në sezon. Shumatorja e pikëve të mbledhura përbën vlerësimin e tij përfundimtar. Forma e vlerësimit referuar ECTS përcaktohen me notë (1 deri 10) dhe ekuivalentin e notave me shkronja nga F në A. Ky sistem vlerësimi përfshin 100 pikë, të cilat janë të ndara kryesisht në:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• 10 % frekuentimi dhe vlerësimi gjatë semestrit;</li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• 30 % provim i ndërmjetëm apo detyra e kursit që zhvillohet në mes të semestrit;</li> <li>• 60% provimi përfundimtar që zhvillohet në fund të semestrit.</li> </ul> <p>Mënyra e vlerësimit të studentëve është e prezantuar në syllabusin e çdo lënde.</p> <p><i>Evidenca nr.5. Rregullore e UET</i></p> <p><i>Evidenca nr.7. Rregullorja e programit të studimit MSH në Financë</i></p> <p><i>Evidenca nr.14. Kurrikula e programit MSH ne "Financë</i></p> <p><i>Evidenca nr.19. Syllabuset e lendeve</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.</p>	<p>Personeli akademik që mbulon këtë program ka aftësitë pedagogjike bashkëkohore në mësimdhënie rrjedhojë kjo edhe e eksperiencës relativisht të gjatë në procesin e mësimdhënies (shih dhe vlerësimet më lart). Nga ana tjetër, nga takimi me studentët e këtij programi, GVJ evidentoi faktin e marrjes parasysh në tre raste të kërkesave të studentëve lidhur me përmirësimin e procesit të mësimdhënies për të kryer më shumë seanca aplikative të modeleve ekonometrike duke rritur nivelin kërkues e shkencor të mësim nxënies nga studentët. Në mbështetje të një performace me të mire mësimdhënieje stafit të programit i kanë shërbyer edhe mobilitetet e realizuara në kuadër të disa programeve ERASMUS + të viteve të fundit. për stafin e ri akademik janë organizuar edhe trajnime specifike metodologjike.</p> <p><i>Evidenca 20.CV e stafit akademik</i></p> <p><i>Evidenca nr.14. Kurrikula e programit MSH ne "Financë</i></p> <p><i>Evidenca nr.19. Syllabuset e lendeve</i></p> <p><i>Evidencë nr. 43.1 të dhëna për shkëmbimin e stafit</i></p> <p><i>Takimi me stafin akademik dhe studentët e programit</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe</p>	<p>Bazuar në takimin me stafin e DEF rezulton se institucioni mbështet stafin akademik në përmirësimin e metodës pedagogjike</p>

<p>në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.</p>	<p>kryesisht nëpërmjet vizitave pranë universiteteve homologe të huaja, si dhe mobiliteteve në kuadër të projektit ERASMUS +.</p> <p>Universiteti organizon në mënyrë periodike Ditën e Zhvillimit të Stafit, me synimin trajnimin e stafit në fusha të lidhura me mësimdhënien, kërkimin, projektet dhe metodologjinë. Gjithashtu në fillim të vitit akademik, universiteti organizon edhe trajnimin dyditor “<i>Back to Work</i>”. Personeli akademik ka mundësi të përfitojë nga programet e shkëmbimit të stafit me universitetet partnere perëndimore, për të shkëmbyer eksperiencë dhe njohur me praktikatat e mirandërkombëtare në fushën e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijes. Në kuadër edhe të zhvillimeve të viteve të fundit stafi akademik ka përdorur edhe platformat e njohura të mësimdhënies online si e-learning Microsoft Teams apo Google Classroom.</p> <p><i>Evidence nr.46.4. Vidio trajnime mbi sistemin TEAMS/LMS Takimi me stafin akademik dhe studentët</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit të student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë. Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Personeli akademik që mbulon këtë program ka ekspertizën e duhur për një proces mësimdhënie të suksesshëm. Bazuar në CV-të e stafit akademik që mbulon këtë program, vëmë re që pothuajse të gjithë kanë një formim akademik dhe profesional në fushën e Financës, menaxhimit të riskut , kontabilitet dhe auditim. Gjithashtu, metodat e mësimdhënies të përdorura nga stafi akademik, përshkruhen në syllabusin e secilës prej lëndëve/moduleve të programit të studimit. Seksioni “Metoda pedagogjike e përdorur në seminarin e radhës”, është një element i rëndësishëm në formatin e miratuar për syllabuset e lëndëve të programit të studimit, duke përshkruar materialet për diskutim dhe rastet studimore për secilën prej temave.</p> <p><i>Evidenca nr.19. Syllabuset e lendeve</i> <i>Evidenca 20.CV e stafit akademik</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësia përgjegjëse për ofrimin e progamit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë</p>	<p>Vlerësimi i formave të mësimdhënies përfshihet si pjesë e raportit të përgatitur nga KSBC dhe analiza e këtij raporti në nivel Departamenti lidhur me problematikën e dalë nga anketimi me studentët e cila analizohet në këtë njësinë bazë. Problematikat e dala nga anketimi i studentëve diskutohen në këtë njësi me synim rritjen e cilësisë së mësimdhënies. Në takimin me studentët e</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

36

<p>studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>programit ata prezantuan edhe sugjerimin që kishin bërë në Departament për disa lëndë që kishin një nivel të lartë teorik shkencor për tu trajtuar në një nivel me aplikativ të cilat ishin marrë në konsideratë nga pedagogët përkatës të lëndëve.</p> <p><i>Evidence nr.30.12.Shembull relacioni i KSBC mbi syllabuset Takimi me studentet gjate vizitës në institucion.</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajtojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të aplikimit evidentojmë se tashme janë miratuar dhe operon strukturat e sigurimit të brendshëm të cilësisë në nivel institucioni që është Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (KSBC). Kështu me Urdhrin Administrativ nr.19 date 12.11. 2021 është ngritur ky komision në nivel institucional. Kjo strukturë ndjek dhe vlerëson cilësinë e mësimdhënies dhe mësim nxënies të programeve të studimit Institucioni nuk ka njësi të sigurimit të cilësisë në nivel të njësisë kryesore. KSB koordinon punën me njësinë bazë që është DEF si njësi bazë e këtij programi.</p> <p>Nga vizita e GVJ në UET dhe dokumentacioni i aplikimit u konstatua se monitorimi dhe vlerësimi i aftësive mësimdhënëse të personelit akademik dhe ndihmës akademik realizohet në mënyrë periodike.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Nga eprori përkatës</li> <li>• Nga studentet</li> <li>• Nga Komisioni i vlerësimit të performances</li> </ul> <p>KSB përqendrohet, midis të tjerash, në zbatimin e mekanizmave për sigurimin e cilësisë në mësimdhënie, vlerësim dhe përfshirjen e studentëve në procesin e të nxënies, evidentimin dhe përcjelljen e problemeve për zgjidhje. KSBC monitoron procesin e vlerësimit të mësimdhënies, hulumton modele të ndryshme, vlerëson veprimtaritë e lidhura me vlerësimin e shërbimeve akademike dhe administrative, etj</p> <p><i>Megjithatë për një efience me të madhe të cilësisë në mësimdhënie kjo strukture duhet të ngrihet edhe në nivel të njësisë kryesore; FEBZH. Këtë e argumentojmë me faktin se FEBZH ka vetëm një përfaqësues në KSBC. Ngritja e këtij komisioni në nivel të njësisë kryesore me anëtarë të vetë kësaj njësie do ketë me shume përgjegjësi dhe mundësi për të realizuar objektivat cilësor të mësimdhënies dhe mësim nxënies të programit të studimit.</i></p>

	<p><i>Evidence nr. 30.16. Formulari i vlerësimit të pedagogut nga eprori</i>  <i>Evidencë nr.40. Format vlerësim pedagogu nga studentet online</i>  <i>Evidencë nr.40.2.Formulari për ankesat e studenteve</i>  <i>Evidencë nr.30.2..Manuali për sigurimin e brendshëm të cilësisë</i>  <i>Evidence nr.30.4. Urdhër administrative për përbërjen e KSBC</i></p>			
<b>Konkluzione</b>	GVJ vlerëson se ky standart plotësohet plotësisht .			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi III.2</b>	
<b>Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	<p>Kriteret dhe mënyra e testimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale janë të përcaktuara qartë në rregulloret e posaçme, të cilat janë pjesë zbatuese si në nivelin institucional (Rregullore e UET), rregulloren e këtij programi si dhe në manualin e zhvillimit të provimit. Këto dokumente janë të publikuara dhe studentët kanë akses në to. Më të specifikuara mënyrat e testimit jepen në syllabuset e lëndëve përkatëse.</p> <p><i>Evidence nr.5. Rregullore e UET</i>  <i>Evidenca nr.7. Rregullore e programit të studimit</i>  <i>Evidenca nr.7.2: Sistemi i vlerësimit të studenteve</i></p>
<b>Kriteri 2.</b> Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	<p>Bazuar në syllabusin e pedagogëve të studimit programin e studimit MSH në “Financë” dhe vizitës në institucion u konstatua se pedagogu i secilës lëndë, javën a parë të mësimit bën prezantimin e përmbajtjes së lëndës, objektivat, temat e lëndës si dhe elementët e tjerë të syllabusit.</p> <p><i>Evidenca nr.19. Syllabuset e lendeve</i>  <i>Takimi me stafin akademik gjate vizitës në institucion</i></p>

<p><b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>Vlerësimi i njohurive të studentëve realizohet në format tashmë të konsoliduar dhe përfshijnë elementë të vlerësimit të vazhdueshëm në seminar, testimin e ndërmjetëm, detyrat e kursit, provimin përfundimtar etj, elementë këto që u evidentuan të përcaktuara në syllabuse në kriteret standarde.</p> <p><i>Evidenca nr.7. Rregullore e programit të studimit</i></p> <p><i>Evidenca nr.7.2: Sistemi i vlerësimit të studenteve</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ bazuar në dokumentacionin e ofruar nga institucioni si dhe vizitën e realizuar në institucion konkludon se ky i fundit ka të plotë kuadrin rregullator, mbikëqyrës dhe procedural të vlerësimit të dije të studentëve gjatë procesit mësimor.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

<p><b>Standardi III.3</b>  <b>Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Vlerësimi i njohurive të studentëve bazohet në praktikat më të mira të përdorura në IAL. GVJ, gjatë vizitës në sekretarinë mësimore, evidentoi praktika vlerësimi të semestrit të dyte të Kursit të I- të të këtij programi, në disa nga lëndët për të cilat ishte përmbyllur vlerësimi. Njohuritë e marra gjatë zhvillimit të këtyre lëndëve në semestrin përkatës vlerësohen deri me 40% të notës përfundimtare (angazhim në seminar dhe detyra/projektet e kursit si dhe testi i ndërmjetëm), ndërsa provimi përfundimtar zë 60 % të vlerësimit, duke reflektuar kështu edhe përcaktimin e këtij vlerësimi sipas syllabusit. Mendojmë se kjo metodë vlerësimi i jep mundësi studentit të angazhohet gjatë gjithë semestrit dhe siguron një vlerësim më objektiv të angazhimit të tij në auditor dhe jashtë tij. Procesi i realizimit të vlerësimit është trajtuar edhe në rregulloren e programi dhe përfshin edhe aspekte të tjera të tij si sekretimin, kohen e shpalljes së rezultateve , ankimimin e studentet etj.</p>



	<p>GVJ evidentoi dhe zhvillimin online të procesit mësimor gjate periudhës se pandemisë e paraprirë me rregulloren përkatëse dhe platformat e përdorura ne këtë proces.</p> <p><i>Evidence nr.5.2.Rregullore tranzitore mbi vijimin e procesit akademik</i></p> <p><i>Evidenca nr.7. Rregullore e programit të studimit</i></p> <p><i>Evidenca nr.7.2: Sistemi i vlerësimit të studenteve</i></p> <p><i>Evidenca nr.7.2:Formati i tezes se provimit përfundimtar</i></p> <p><i>Vizita në institucion e GVJ ( pranë sekretarisë mësimore)</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>Pothuajse të gjitha vlerësimet e lendeve të programit realizohen me shkrim ne baze të modelit të aprovuar të tezes se provimit. Dy vitet e fundit UET ka filluar të aplikojë sistemin e vlerësimit elektronik dhe ka aplikuar disa vlerësime lendesh me sistemin elektronik të testimit (<i>Projekti clean score</i>), por ende ne këtë program ky vlerësim nuk është aplikuar.</p> <p><i>Vizita në institucion e GVJ ( pranë sekretarisë mësimore)</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.</p>	<p>Për realizimin e vlerësimin përfundimtar të dijeve të studentëve DEF, bazuar në rregulloret përkatëse ne nivel institucional dhe të vete këtij programi , në bashkëpunim me sekretarinë mësimore, miratojnë komisionet e provimit me një numër anëtarësh stafi jo më pak se 2, ku njëri është titullari i lëndës dhe tjetri është pedagog i fushës përkatëse. GVJ evidentoi nënshkrimin e anëtarëve të komisionit në procesverbalet e provimeve të lëndëve, si dhe praktikave profesionale të firmosura nga 2 anëtarët e komisionit të provimit dhe Përgjegjësi i DEF.</p> <p><i>Vizite e GVJ në sekretarinë mësimore</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të</p>	<p>Zhvillimi i testimit të vlerësimit bazohet në anonimitetin dhe monitorim nga DEF. Kushtet e zhvillimit të provimit janë optimale dhe hapësirat ndërmjet studentëve në këtë proces janë të përshtatshme. Në raste zhvillimit të testimit në laborator shtohet dhe personel mbikëqyrës gjatë zhvillimit të provimit. Formatu i tezes se provimit ka si seksion me vete komentet e pedagogut për</p>





<p>nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>përgjigjet e studentit për pyetjet që kërkojnë qëndrim/opinion të studentit. Në fund të tezes është vlerësimi i detajuar sipas pyetjeve teorike dhe ushtrimeve.</p> <p><i>Evidenca nr.7.2:Formati i tezes se provimit përfundimtar</i> <i>Vizita në institucion e GVJ ( pranë sekretarisë mësimore)</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>Bazuar në kuadrin e brendshëm rregullator si dhe nga takimi me stafin akademik dhe studentet e programit evidentohet korrektësia e zhvillimi të provimit si me monitorimin nga dy pedagogë anëtarë të komisionit ashtu edhe moslejimi i përdorimit të celularëve apo formave të tjera të kopjimit.</p> <p><i>Evidenca nr.7. Rregullore e programit të studimit</i> <i>Evidenca nr.7.2: Sistemi i vlerësimit të studenteve</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin përkatës por edhe gjate takimeve me stafin akademik dhe studentet evidentohet se vlerësimi i dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën, ku pedagogu krahas realizimit të sekretimit të tezave shpall rezultatet e vlerësimit brenda kohës së parashikuar sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse. Dorëzimi i vlerësimeve të provimeve bëhet brenda 2 (dy) javëve nga data e zhvillimit të tyre, brenda të cilave përfshihen edhe seancat sqaruese. Në rastin e riprovimeve, duke qenë se numri i studentëve pjesëmarrës është më i ulët se në sezonet normale, afati për dorëzimin e korigjimeve është 1 (një) javë. Vlerësimi për komponentët e tjerë duhet të dorëzohen përpara zhvillimit të provimit përfundimtar, dhe pedagogu nuk ka të drejtë të ndërhyjë për ndryshim pas zbardhjes së rezultateve të provimeve.</p> <p><i>Evidenca nr.7. Rregullore e programit të studimit</i> <i>Evidenca nr.7.2: Sistemi i vlerësimit të studenteve</i> <i>Vizita në institucion e GVJ ( pranë sekretarisë mësimore)</i></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të</p>	<p>Bazuar në rregulloret përkatëse të studimit student ka 3-5 dite kohe pas shpalljes së rezultatit të vlerësimit që të beje ankese nëse ai ka pretendime për një vlerësim me të lartë. Institucioni ka model formulari tip për ankimimin e student. Atij i jepet mundësia</p>




<p>vlërësimit në përputhje me me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>të ballafaqohet me pedagogun e lendes dhe vlerësimin e bere si dhe I jepet përgjigja edhe e shkruar ne formular. Nga takimi me studentet e këtij program gjate vizitës ne institucion ata nuk kishin pasur praktike të tille. Reklamimi për vlerësimin nuk kishte shkruar ne këtë faze pasi ishte zgjidhur gjate takimit qe pedagogu I lendes zhvillon me studentet ne datën e paracaktuar para se të hedhe vlerësimet përfundimisht ne sistem.</p> <p><i>Evidence nr.40.2. Formular për ankesat e studenteve Vizita në institucion e GVJ; takimi me studentet e programit</i></p>			
<p><b>Kriteri 8.</b> Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>Në rast të kërkesës për ankimim qe bën student sipas formularit të miratuar pasi është ezauruar takimi me pedagogun e lendes Dekani ne bashkëpunim me përgjegjësën e DEF ngre një komision për rivlerësim të provimit. Në përfundim të vlerësimit Komisioni jep vendimin final duke e bere transparente procesin me studentin dhe pedagogun e lendes përkatëse. Për ketë program ne nuk evidentuam një realizim praktike të tille.</p> <p><i>Evidence nr.40.2. Formular për ankesat e studenteve Vizita në institucion e GVJ; takimi me studentet e programit</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p>GVJ bazuar në dokumentacionin e ofruar nga institucioni si dhe vizitën e realizuar në institucion konkludon se arrihet një vlerësim i drejtë i dijeve të studenteve duke respektuar konfidencialitetin, paanësinë dhe të drejtën e ankimit nga studentet dhe zgjidhjes së saj.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht <b>X</b></p>

<p><b>Standardi III.4</b> <b>Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve.</p>	<p>Bazuar në planin mësimor, programi i studimit MSH në "Financë", ne të tre profilet bazohet mbi njohuritë e marra ne ciklin e pare të studimit ne Financë dhe garanton thellimin e njohurive, zhvillimin e aftësitë profesionale dhe shkencore të studentëve në fushën e financës, kontabilitetit dhe auditimit. Mbështetur në</p>



	<p>module që ofron programi, por edhe në praktikën profesionale të përfshirë në të që në semestrin e parë, ai arrin të ketë objektiv formimin teorik, profesional dhe relativisht edhe atë shkencor të studentëve.</p> <p><i>Evidenca nr.14. Kurrikula e programit MSH në "Financë"</i> <i>Evidenca nr.19. Syllabuset e lendeve</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).</p>	<p>Bazuar në programin e studimit MSH në "Financë", si dhe syllabuseve të lëndëve shikohet se zhvillohen aftësi të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, komunikimit dhe ndërveprimit.</p> <p>Njëkohësisht gjejmë relativisht trajtime në zhvillimin e aftësive në fushën e informacionit në trajtimin e rasteve studimore në një numër lëndësh të këtij programi. Lende të tilla si "Metodat e kërkimit në Financë", "Teori financiare apo "Standardet ndërkombëtare të raportimit financiar" në të cilat përdoren dhe programet aplikative kompjuterike rrisin me tej aftësinë e përdorimit të teknologjisë së informacionit, komunikimit dhe ndërveprimit si aspekte të rëndësishme të fitimit të dijeve në këto fusha.</p> <p><i>Evidenca nr.14. Kurrikula e programit MSH në "Financë"</i> <i>Evidenca nr.19. Syllabuset e lendeve</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse.</p>	<p>Nga takimi me stafin e programit dhe studentët, GVJ evidentoi që në orën e fundit të leksionit/seminarit bashkëbisedohej mes pedagogut dhe studentit realizimi i programit të lëndës (bazuar në syllabusin e paraqitur që në fillim të semestrit). Përfitimet e marrjes së njohurive shihen të lidhura ngushte edhe me mundësinë e aplikimit të tyre në pozicione të ndryshme të punës në sektorin e financës.</p> <p><i>Vizita në institucion dhe takimi me stafin e programit dhe studentet</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë</p>	<p>Bazuar në dokumentacion dhe takimin e zhvilluar me stafin e programit, konstatohet që anëtarë të tij realizonin zhvillimin e programit në tema të caktuara nëpërmjet punëve laboratorike. Më</p>

<p>studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuarra kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>e theksuar kjo realizohet në lëndët e “Metoda kërkimi ne finance”, “Menaxhim financiar”, “ Qeverisja korporatave” , etj, lëndë këto që në aplikimin e tyre kërkojnë edhe një angazhim shtesë jashtë kornizës së syllabusit duke u zhvilluar në laborator.</p> <p>Eksperienca e stafit akademik si dhe mobilitetet e realizuara prej tyre ne kuadër të programit ERASMUS+, apo pjesëmarrës ne projektet kërkimore mundësojnë rritjen e nivelit të mësimdhënies.</p> <p><i>Evidenca nr.14. Kurrikula e programit MSH ne “Financë</i>  <i>Evidenca nr.19. Syllabuset e lendeve</i>  <i>Evidenca nr.43.1.Raporti i mobiliteteve staf student</i>  <i>Vizita në institucion dhe takime me stafin akademik dhe studentet</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>UET tashme ka një tradite të pasur ne zhvillimin e leksioneve të hapura me personalitete të fushave të ndryshme, të cilat realizohen kryesisht ne rang institucional. Edhe DEF organ leksione të hapura me studentet e këtij program. Qe në fillim të vitit akademik kjo njësi baze harton kalendarin e aktiviteteve ne baze të propozimeve qe anëtarë të stafit do të angazhojnë personalitete të fushës se ekonomisë apo financës. Ne takimin me studentet e programit ata konfirmuan pjesëmarrje ne disa leksione të hapura qe janë zhvilluar ne FEBZH.</p> <p><i>Evidenca nr.56.R Kalendar i aktiviteteve të departamentit.</i>  <i>Vizita në institucion dhe takime me stafin akademik dhe studentet</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuarra kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.</p>	<p>Nga takimi me studentët e programit GVJ evidentoi që mbështetja e studentëve konsiston në krijimin e klimës favorizuese dhe të përshtatshme për të realizuar detyrat e kursit. Kjo arrihet nëpërmjet kontakteve apo njohjeve që pedagogu i lëndës ka me drejtues institucionesh duke mundësuar angazhimin e tyre me studentët sidomos gjate realizimit të praktikës.</p> <p><i>Vizita në institucion dhe takime me stafin akademik dhe studentet</i></p>

<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ evidenton se programi i studimit garanton dhënien e njohurive të thelluara teorike shkencore dhe aplikative me tipare të një programi mësimor të nivelit të dyte MSH. Përsa i përket standartit III.4, GVJ shprehet se përmbushet plotësisht</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi III.5</b>	
<b>Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike dhe e bën atë publike.	<p>Studentët e këtij programi, pas përmbylljes së gjithë detyrimeve, kanë të drejtën e mbrojtjes së diplomës përmes një punimi Mikroteze. Procedura e mbrojtjes përfundimtare, diplomimit, është e përcaktuar në rregulloren e programit të studimit ( neni 8 ) dhe rregulloren e Fakultetit të Ekonomisë. Ky proces është me i detajuar në udhëzuesin e mbrojtjes së diplomës si nje dokument me vehte. Në këtë udhëzues jepen detaje lidhur me strukturën e punimit të mikrotezës, listën e pedagogëve udhëheqës, listën e sugjeruar të temave të mundshme orientuese etj. Të gjitha procedurat e posaçme lidhur me mbrojtjen e diplomës hartohen nga institucioni dhe bëhen publike për të gjithë studentët.</p> <p><i>Evidenca nr.7.Rregullore e programit të studimit MSH në Financë</i></p> <p><i>Evidenca nr.10. Mbi punimin e diplomës dhe disertacionit</i></p>
<b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të të detyrimeve përmbyllëse.	<p>DEF, si njësi bazë e programit, së bashku me strukturat ndihmëse, informojnë, ndjekin dhe monitorojnë procesin përgatitjes dhe mbrojtjes së diplomës me punimin e Mikrotezës. Pas marrjes së informacionit studentët plotësojnë formularin e aplikimit ku përcaktojnë fushën e studimit, strukturën paraprake të tij dhe propozimin për udhëheqësin e punimit. Në DEF përcaktohen udhëheqësit për çdo student, të cilët kanë përgjegjësi për mbarëvajtjen e këtij procesi, cilësinë dhe përfundimin në afat. Ky proces u evidentua edhe gjatë vizitës në institucion. Ne ndihme të studenteve për këtë qellim organizohet seanca metodologjike ne auditor ku jepen udhëzimet përkatëse për përgatitjen e punimit</p>

	<p>përmbyllës. Kjo seance që zhvillohet 1 ore në javë bazohet në syllabusin përkatës dhe ka fokus përgatitjen e një punimi diplome/shkencor dhe është planifikuar të zhvillohet gjatë semestrit të I dhe të II-te.</p> <p><i>Takim me stafin dhe studentet në institucion</i></p> <p><i>Evidenca nr.10. Mbi punimin e diplomës dhe disertacionit</i></p> <p><i>Evidenca nr.19.2. Syllabus, seancat metodologjike</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Lidhur me diplomimin e studentëve, me propozim të përgjegjës të Departamentit dhe miratimit nga Dekani, ngrihet Komisioni i Provimit të Formimit i cili në vlerësimin e punimit të Mikrotezës bazohet në katër kritere kryesore:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ecurinë dhe nivelin e vlerësimit të marrë në mësimet gjatë vitit akademik;</li> <li>• Vlerat teorike shkencore dhe profesionale të punimit;</li> <li>• Vlerësimin që jep pedagogu udhëheqës i punimit të studentit në formularin përkatës;</li> <li>• Nivelin e prezantimit të punimit nga studenti.</li> </ul> <p>GVJ konstatoi se kjo praktikë rezulton e plotësuar nga evidentimi me studentë të programeve të tjera që kanë përfunduar programin, pasi studentët e këtij programi ende nuk e kanë përmbyllur programin.</p> <p><i>Takim me stafin dhe studentet në institucion.</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik/Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo</p>	<p>Në funksion të fushës së punimit të propozuar nga studenti, Departamenti i Financës miraton listën e pedagogëve udhëheqës për temat e studentëve. Udhëheqësit e punimeve të Mikrotezës gjatë periudhës së përgatitjes së tij nga studenti mbajnë komunikim të vazhdueshëm duke i orientuar përgjatë kësaj kohe. Roli udhëheqës i pedagogut është këshillues dhe orientues lidhur me përmbushjen e objektivave të qëllimit të punimit, shfrytëzimin e literaturës bashkëkohore nga studenti dhe përfshirja e analizës teorike praktike në punim.</p> <p>Nga takimi me studentët e Kursit të II-të të këtij programi, u evidentua bashkëpunimi deri në këtë fazë afër përmbylljes të</p>

<p>nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>realizimit të punimit të mikrotezës me udhëheqësin e punimit. Kjo manifestohet në ndjekjen sistematike dhe këshillat e vazhdueshme për studentët, duke filluar që nga faza e konceptimit. Rol të rëndësishëm ai ka në asistencën që jep sidomos me metodologjinë e punimit që është kyçi i një punimi të suksesshëm dhe sidomos në aspektin e aplikimit të të dhënave të siguruara. Në rastin e punimeve të Mikrotezës për studentët e këtij programi synohet që ai në strukturë trajtimi aplikativ të zërë një peshë të konsiderueshme.</p> <p><i>Takim me stafin dhe studentet në institucion.</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Gjatë përpunimit të të dhënave të punimit studentët kanë të gjitha mundësitë teknike dhe asistencën e nevojshme për të realizuar këtë fazë të rëndësishme të punimit në laboratorët që ofron institucioni, bibliotekën dhe çdo infrastrukturë të dobishme për ta.</p> <p><i>Takim me stafin dhe studentet në institucion</i></p> <p><i>Evidenca nr.10. Mbi punimin e diplomës dhe disertacionit</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>Komisioni i Provimit të Formimit bazuar në 6 komponentët e vlerësimit të përcaktuara në formularin përkatës dhe të plotësuar nga pedagogu udhëheqës i punimit si dhe vlerësimin nga prezantimi i punimit para tyre bën vlerësimin e punimit të Mikrotezës me notë përfundimtare dhe i behet të ditur studentit në fund të seancës së mbrojtjes.</p> <p><i>Për një efikasitet me të arte të rolit të udhëheqësit të punimit të diplomës, mendojmë se duhet reduktuar edhe me tej numri i studenteve që udhëheq një pedagog pasi ende disa pedagoge kanë në udhëheqje 10 deri 15 studente ( në vitin akademik 2022-2023 ) duke angazhuar personel akademik shtese PAE apo PAK.</i></p> <p><i>Evidenca nr.5. Rregullore e UET</i></p> <p><i>Evidenca nr.10. Mbi punimin e diplomës dhe disertacionit</i></p> <p><i>Takim me stafin dhe studentet në institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me</p>	<p>Në përfundim të studimeve studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e saj të miratuar nga MASR. Diplomës i</p>

<p>diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>bashkëngjitet edhe lista e notave. GVJ verifikoi praktikën përkatëse lidhur me diplomimin e studentëve në këtë program që i përket vitit akademik 2020-2022. Në rast se studenti kërkon dhe kopje të programit të studimit me përmbajtjen lëndore me kërkesën e tij ai pajiset me këtë dokumentacion brenda afatit të caktuar në rregullore kundrejt pagesës së tarifës.</p> <p><i>Evidence nr.5. Rregullore e UET</i></p> <p><i>Evidence nr.15.1. Modeli i diplomës dhe suplementi i saj</i></p> <p><i>Takim në sekretarinë e institucionit</i></p>			
<p><b>Kriteri 8.</b> Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.</p>	<p>Nga vizita në institucion rezulton se procesi i ruajtjes së gjithë dokumentacionit bazohet në kërkesat ligjore dhe aktet nënligjore në fuqi. Gjithashtu të dhënat e tij ruhen edhe në sistemin informativ të institucionit.</p> <p><i>Evidence nr. 9. Mbi funksionimin e sekretarisë mësimore</i></p> <p><i>Takim në sekretarinë e institucionit</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p>GVJ vlerëson se institucioni ka një procedure të qarte të detyrimeve përmbyllëse të studenteve dhe i pajis ata me dokumentacionin e nevojshëm në përfundim të programit. Për një efikasitet me të mirë të realizimit të punimit përmbyllës të studentëve, rekomandojmë që numri i udhëheqjeve të studentëve nga një pedagog të jete më i ulët. Ky standard plotësohet kryesisht</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes sëstandardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
<p>X</p>				

**Standardi III.6**

Në rastin e programit të studimit në “Master Profesional” institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfutimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të</p>	<p>Nuk aplikohet për këtë program MSH</p>





përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.				
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.	<b>Nuk aplikohet për këtë program MSH</b>			
<b>Kriteri 3.</b> Praktikrat profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.	<b>Nuk aplikohet për këtë program MSH</b>			
<b>Konkluzione</b>	<b>Nuk aplikohet për këtë program MSH</b>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

**IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA  
PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT**

**Standardi IV.1**

**Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.</p>	<p>Personeli akademik përfshinë individë me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, të cilët janë të përfshirë në zhvillimin e programit të studimit të financës me profile dhe përmbushin kërkesat ligjore aktuale. Zyra e Burimeve Njerëzore është përgjegjëse për menaxhimin e dokumentacionit të personelit, duke i përditësuar dosjet. Detyrat dhe të drejtat e stafit drejtues dhe mësimdhënës janë përcaktuar në dokumente të ndryshme, përfshirë Statutin, Rregulloret e institucionit, Kodin e Etikës dhe Kodin e Integritetit Akademik, si dhe në kontratat individuale të punës dhe anekset e tyre.</p> <p>Personeli akademik për këtë program studimi rezulton në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe disa prej tyre kanë edhe ekspertizën e nevojshme për lëndët që mbulojnë.</p> <p>Në vitet e ndryshme akademike, ka pasur ndryshime në numrin dhe gradat e pedagogëve të përfshirë në programin e studimit të financës me profile.</p> <p><i>[Evidenc: Ligji 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë të Republikës së Shqipërisë”; RVB; Statuti UET, Rregullore për Burime Njerëzore; Tabelat përmbledhëse]</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.</p>	<p>Personeli akademik efektiv është përgjegjës për zbatimin e detyrave mësimore të këtij programi studimi në përputhje me legjislacionin dhe rregullat e brendshme. Shpërndarja e ngarkesës mësimore në programin e studimit kryhet në përputhje me udhëzimet përkatëse, duke respektuar raportin 70/30 të totalit të orëve mësimore të mbuluara nga personeli akademik efektiv, por</p>

	<p>Bazuar në evidencat e depozituara GVJ evidenton se janë përfshirë në mësimdhënie në programin Master Shkencor si personel akademik pedagog të cilët nuk janë të kategorisë Profesor apo të zotërojnë gradë shkencore, përgjatë viteve të marra në shqyrtim kjo evidentohet në mbi 7 raste në mospërputhje me kërkesat ligjore në fuqi.</p> <p><i>[Evidenc: RVB; Tabelat përmbledhëse; Ligji 80/2015 "Për arsimin e lartë"; VKM 41]</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p>	<p>Referuar RVB, Institucioni ofron nënshkrimin e kontratave të punës dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore, por UET aplikon fillimisht kontrata me afat vetëm për një vit dhe vetëm pas kësaj periudhe dhe nëse kushtet e vendosura nga UET janë të plotësuara, pedagogët me gradë shkencore kanë mundësinë të lidhin kontrata pune pa-afat apo me një afat të përcaktuar. Kjo është trajtuar edhe në kriterin 1 më sipër.</p> <p><i>[Evidenc: Ligji 80/2015 "Për arsimin e lartë"; RVB; Statuti UET, Rregullore për Burime Njerëzore; Tabelat përmbledhëse]</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Përzgjedhja e personelit: Përzgjedhja e stafit akademik bëhet duke marrë parasysh mungesat në stafin ekzistues, ekspertizat e tyre, dhe ngarkesën mësimore. Ky proces ka për qëllim të sigurojë që personeli i përzgjedhur të ketë kualifikimet e duhura dhe të përshtatet me strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimit.</p> <p>Procedurat e rekrutimit dhe vlerësimit: Institucioni ndjek procedura të përcaktuara, të përfshira në dokumentet e brendshme të institucionit, që kujdesen për zbatimin e kriteve të përgjithshme dhe specifike të shpallura. Ky proces siguron transparencë dhe objektivitet gjatë rekrutimit.</p> <p>Institucioni përkujdeset për zhvillimin dhe rritjen profesionale të personelit akademik pas rekrutimit. Kjo është një përpjekje për të siguruar që personeli të përmbushë objektivat e programit të institucionit.</p> <p><i>[Referenca: RVB; Statuti UET, Rregullore për Burime Njerëzore; Shembull<sup>1</sup>]</i></p>

<sup>1</sup> Shembull thirrje për staf akademik <https://uet.edu.al/thirrje-per-aplikim-per-tu-bere-pjese-e-stafit-akademik-uet/> (Ref. Nr. 11.1)  
 Adresa: "Rruga e Durrësit"  
 Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
 Tel:+355 (04) 222-43423

<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>Gjatë vizitës në IAL, GVJ nuk mori përgjigje për pyetjen: A keni personel ndihmës akademik për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore?</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.</p>	<p>Gjatë vizitës në zyrën e Burimeve Njerëzore u konstatua se çdo pjesëtar i personelit akademik kishte një dosje të veçantë personale që ishte krijuar nga Zyra e Burimeve Njerëzore. Kjo zyrë mblidhte dhe rishikonte të dhënat e personelit akademik dhe i vendoste ato në dosje.</p> <p>GVJ kërkoi dhe verifikoi me përzgjedhje të rastësishme nga 1 dosje të PAE dhe PAK dhe u pa se dosja përmbante informacionin që ishte i definuar nga Rregullorja për Burimet Njerëzore, që zbatohet për të gjithë pjesëtarët e stafit.</p> <p><i>[Referenca: RVB; Vizita në IAL; Rregullore për Burimet Njerëzore]</i></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në informacionin e marrë nga RVB dhe Tabela përmbledhëse, konstatohet se UET bashkëpunon me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues të biznesit, dhe organizata të tjera për të udhëzuar, drejtuar dhe monitoruar studentët në përfshirjen e tyre në praktikën profesionale. Gjithashtu, Departamenti ofron staf akademik efektiv për të supervizuar punimet e diplomës, dhe studentët kanë mundësinë të zgjedhin se me cilin prej pedagogëve dëshirojnë të punojnë në projektin e tyre shkencor. Nga GVJ u evidentua se çdo PAE me grada apo tituj kishte një numër të konsiderueshëm studentësh për të udhëhequr duke krijuar kështu një ngarkesë të konsiderueshme për PAE dhe kohën e tyre në dispozicion të çdo studenti, kjo e konfirmuar edhe nga takimi me studentët.</p>





	<i>[Referenca: RVB; Vizita në IAL; UET Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit; Aneks Tabela 5]</i>			
<b>Kriter 8.</b> Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.	Referuar RVB shikojmë se për këtë kriter përgjigja ishte vet kriteri, pa dhënë asgjë konkrete përsa kërkuar nga kriteri. Gjithashtu, pyetjes së GVJ bërë studentes (anëtare e GVB) ajo ju përgjigj se, për zhvillimin e lëndës së praktikës mjafton që jemi të punësuar dhe nuk kemi çfarë të bëjmë më tepër.  <i>[Referenca: RVB; Vizita në IAL]</i>			
<b>Konkluzione</b>	GVJ evidenton se: <ul style="list-style-type: none"> <li>• në programin Master Shkencor janë përfshirë si personel akademik në mësimdhënie pedagog të cilët nuk janë të kategorisë profesor apo të zotërojnë gradë shkencore, përgjatë viteve të marra në shqyrtim kjo evidentohet në mbi 7 raste duke bërë që IAL të jetë në mospërputhje me kërkesat ligjore në fuqi.</li> <li>• Nuk ka përgjigje nga IAL nëse ka të punësuar personel ndihmës akademik për realizimin e orëve laboratorike.</li> </ul>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

#### Standardi IV.2

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të	Sipas RVB, në objektin e mëparshëm deri në fillim të vitit akademik 2021-2022, UET kishte në përdorim për të gjitha programet e studimit: 14 salla seminari, çdo njëra me 35 vende/karrige, 9 salla leksioni dhe seminari me 70 vende, 3 salla laboratorë informatike me kapacitet për 35 vende, 1 sallë interneti me 80 kompjutera, dhe 1 sallë bibliotekë me 150 vende leximi. Ndërsa nga shtatori i vitit 2021, UET ka shkuar në një tjetër adresë, dhe ka në përdorim për të gjitha programet e studimit: 13 salla për

<p>studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>seminare me 353 vende, 15 salla leksioni me 1138 vende, 7 laboratorë informatike me kapacitet për 190 vende, dhe 1 sallë interneti me 70 vende.</p> <p>Gjatë intervistave në IAL, u shprehën se kanë marrë lejen për ndërtimin e kampusit të UET dhe kjo do t'ju shtoj kapacitetet në dispozicion dhe kushte më të mira, pasi aty ku janë ndihen të kufizuar në ambientet në përdorim.</p> <p><i>[Referenca: RVB; Vizita në IAL; UET Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit; Infrastruktura në funksion të programeve të studimit – Blv. "Gjergj Fishta"; Infrastruktura në funksion të programeve të studimit – Rr. "Xhanfize Keko"]</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Referuar RVB, mjediset e punës dhe ato mësimore kanë pajisje audiovizuale, kompjutera, projektorë, internet, si edhe kondicionimi i ajrit ishte i përfshirë në çdo ambient.</p> <p>Referuar vizitës që GVJ kreu në klasat/ambientet ku bëhej mësim përveç sa më sipër konstatoi se ambientet (klasat) mësimore të vizituara gjatë vizitës në IAL rezultonin të kishin kamera vëzhgimi brenda në klasë, duke cënuar të drejtat e palëve si edhe ekspozimin ndaj shkeljes së kërkesave ligjore për të dhënat personale.</p> <p><i>[Referenca: RVB; Vizita në IAL]</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Referuar vizitës që GVJ kreu në klasat/ambientet ku bëhej mësim përveç sa më sipër konstatoi se çdo ambient përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme mësimore si dhe kamera vëzhgimi edhe brenda në klasa.</p> <p><i>[Referenca: RVB; Vizita në IAL]</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe</p>	<p>Institucioni disponon laboratorë të teknologjisë së informacionit të pajisur me PC dhe programe që i shërben studentëve të këtij programi studimi për aq sa është konsideruar e nevojshme që t'i shërbejnë sa më mirë zhvillimit të mësimin.</p>

profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	<i>[Referenca: Infrastruktura në funksion të programeve të studimit – Blv. "Gjergj Fishta"; Infrastruktura në funksion të programeve të studimit – Rr. "Xhanfize Keko"]</i>		
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe ambulatorie me kapacitetet e nevojshme.	Gjatë vizitës në IAL nga studentët na u evidentua se ata i zhvillonin praktikat pranë vendeve ku punonin ose në organizata me të cilat UET bashkëpunonte. GVJ pyeti drejtues të intervistuar nëse IAL hartonte raporte periodike vlerësimi të bashkëpunimeve me partnerët dhe ata u shprehën se kryenin dhe dërguan përmes sistemit AMS evidenca konkrete përsa kërkohet në këtë kriter.  <i>[Referenca: RVB; Vizita në IAL; UET Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit; Lista e subjekteve dhe institucioneve bashkëpunuese për programin e studimit dhe praktikat profesionale; Aneksi- Tabela 5]</i>		
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ për këtë standard nuk eidenton gjetje që mund të ndikojnë deri në mos përmbushjen e standardit</i>		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X

#### Standardi IV.3

**Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe	Biblioteka e UET për shkak të ndryshimit të ambienteve ende nuk kishte shfaqur për studentët gjithë kapacitetin e librave të disponueshme. Si çdo universitet tjetër në Shqipëri, edhe UET ka akses në biblioteka online të tilla si SAGE dhe EBSCO. Sipas RVB, në vitin e akademik 2020-2021, biblioteka e UET dispononte 1392

<p>njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>artikuj, ndërsa në vitin akademik 2021-2022, ky numër u rrit në 1708 artikuj.</p> <p>Megjithatë, evidentohet edhe prej studentëve se sipërfaqja e sallës së leximit të bibliotekës (50m2) është shumë e vogël për numrin e konsiderueshëm të studentëve që ka ky universitet.</p> <p><i>[Referenca: RVB; Vizita në IAL; Infrastruktura në funksion të programeve të studimit – Blv. “Gjergj Fishta”; Infrastruktura në funksion të programeve të studimit – Rr. “Xhanfize Keko”]</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësimet e literaturës me botime të viteve të fundit.</p>	<p>Njësia bazë mban komunikim të vazhdueshëm me stafin akademik dhe Përgjegjëses së Bibliotekës për pasurimin e fondit të bibliotekës me literaturë të nevojshme, me qëllim zhvillimin normal të procesit mësimor në këtë program studimi.</p> <p><i>[Referenca: RVB; Vizita në IAL; Dokumenti “Mbi funksionimin e bibliotekës”; Infrastruktura në funksion të programeve të studimit – Blv. “Gjergj Fishta”; Infrastruktura në funksion të programeve të studimit – Rr. “Xhanfize Keko”]</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>Referuar konstatimit të dhënë për kriterin 1 në këtë standard, shprehim kufizimin që ka salla e bibliotekës së UET për numrin e konsiderueshëm të studentëve që ka ky universitet.</p> <p><i>[Referenca: RVB; Vizita në IAL]</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>RVB evidenton se biblioteka e UET është e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, në gjuhën shqipe dhe të huaj, të përshtatshme për natyrën dhe specifikën e këtij programi studimi, si edhe rreth 1391 artikuj për programin e studimit Master Shkencor në Administrim Biznesi, por RVB nuk na evidenton sa artikuj janë për Masterin Shkencor në Financë me profile, i cili është edhe objekt vlerësimi.</p> <p><i>[Referenca: RVB; Vizita në IAL]</i></p>





<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Biblioteka online të fushës së programit të studimit të evidentuara nga GVB janë: Sage, Ebsco, Questia Edward Elgar Publishing, ASTM Compas. Nga GVB u këshillua të shikohet mundësia e lidhjes së marrëveshjes edhe me McGrew Hill dhe PEARSON, megjithatë kjo mund të vijë me kosto shtesë për IAL-në.</p> <p><i>[Referenca: RVB; Vizita në IAL]</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.</p>	<p>Biblioteka ishte e pajisur me PC që mundësonin aksesin e studentëve në literaturë online dhe akses në katalogë online për libra elektronike në gjuhë të ndryshme.</p> <p><i>[Referenca: RVB; Vizita në IAL]</i></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>Për studentët e programit Master i Shkencave në Financë, shërbimi i bibliotekës ishte në gjashtë ditë të javës, nga e Hëna në të Premte nga ora 09:00 deri në orën 20:00 dhe për ditën e Shtunë nga ora 10:00 deri në orën 17:00.</p> <p><i>[Referenca: RVB; Dokumenti "Mbi funksionimin e bibliotekës"; Vizita në IAL]</i></p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj,</p>	<p>Evidentojmë se në RVB nuk ka asnjë evidencë për ndonjë raport të përpiluar nga biblioteka dhe njësitë përgjegjëse e programit të studimit për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online, përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e këtij programi studimi. Në mungesë të këtij raporti nuk mund të bëhen analiza të tjera të nevojshme.</p>

por edhe për performancën e personelit akademik.				
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ për këtë standard nuk evidenton gjetje që mund të ndikojnë deri në mos përmbushjen e standardit.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

#### Standardi IV.4

**Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	<p>Zyra e Regjistrimit të Studentëve dhe Sekretaria Mësimore në UET ruajnë dhe përdorin të dhënat e studentëve. Disa pikë kyçe janë:  Ruajtja e të dhënave: Zyra e Regjistrimit dhe Sekretaria Mësimore ruajnë të dhënat e studentëve që nga regjistrimi në universitet deri në lëshimin e diplomave dhe çertifikatave. Regjistrimi në UMIS: Të dhënat e studentëve regjistrohen në Sistemin e Menaxhimit të Universitetit (UMIS), një sistem informatik i specializuar për menaxhimin e të dhënave të universitetit.  Përditësimi elektronik i të dhënave: Të dhënat personale të studentëve përditësohen edhe në versionin elektronik të sistemit.  Konfidencialiteti, siguria dhe integriteti: Parimi kryesor i ruajtjes së të dhënave është siguria, konfidencialiteti dhe integriteti i tyre, që do të thotë që të dhënat janë të mbrojtura dhe të qëndrueshme.  Verifikimi i të dhënave: Para diplomimit, verifikohet saktësia e të dhënave në sistemin elektronik.  Trajnim për pedagogët: Pedagogët brenda ose jashtë universitetit janë të detyruar të ndjekin trajnime metodologjike dhe të njohin dokumentet e UET, Modulin Metodologjik dhe UMIS për të qenë të kualifikuar për punën e tyre.  Informimi i studentëve: Studentët informohen për procesin mësimor përmes sistemit UMIS dhe LMS (Sistemi i Menaxhimit të Mësimimit), dhe ata kanë një manual të përdoruesit për të njohur dhe përvetësuar sistemin UMIS. Për pyetjen e GVJ, se kush i ka prodhuar UMIS dhe LMS dhe çfarë certifikimi kanë për sigurinë e tyre, nga të intervistuarit na u tha se do të merrnin informacion dhe</p>

	<p>do të na dërgonin atë si evidencë shtesë, por kjo evidencë nuk u dërgua.</p> <p><i>[Referenca: RVB; Vizita në IAL; Dokumenti "Mbi funksionimin e sekretarisë mësimore"; Manuali i përdoruesit të sistemit UMIS; UET LMS Guidë për pedagogun]</i></p>
<p><b>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</b></p>	<p>Sipas RVB dhe evidencave të depozituara, UET ka një databazë me emërtimin "Dokumenta UET," në të cilën secili anëtar i institucionit ka akses në kohë reale për të shfletuar dhe gjetur informacione të ndryshme lidhur me aktivitetin e personelit akademik dhe administrativ, si dhe partnerët e angazhuar në realizimin e programit. Disa pika kyçe janë:</p> <p>Databaza "Dokumenta UET": Ekziston një databazë me emërtimin "Dokumenta UET" në kompjuterat e zyrave të stafit akademik dhe administrativ. Kjo databazë përmban informacione të ndryshme lidhur me strategjitë, rregulloret, urdhërat administrativ, standardet, dhe dokumentacionin tjetër që ka të bëjë me aktivitetin e personelit akademik dhe administrativ në universitet.</p> <p>Integrimi i të dhënave në sistemin UET LMS: Për personelin akademik dhe ndihmës akademik, të dhënat e tyre në lidhje me veprimtarinë mësimore janë të integruara në sistemin UET LMS (Sistemi i Menaxhimit të Mësimit të Universitetit Evropian të Tiranës). Kjo përfshin informacione mbi materialet e leksioneve dhe seminareve, detyrat e kursit ose ese, tezat e provimeve, dhe rezultatet e vlerësimit të studentëve.</p> <p>Komunikimi me studentët: Personeli akademik dhe ndihmës akademik komunikon me studentët përmes e-mail, forumeve, chat-et, dhe ndërtonte tjera platforma të komunikimit. Kjo është për të ndihmuar në përmirësimin e përvojës mësimore të studentëve dhe për të ofruar mbështetje.</p> <p>Përmes këtyre veprimeve, UET siguron që informacioni i rëndësishëm dhe dokumentacioni i nevojshëm për aktivitetin akademik dhe administrativ të institucionit të jetë i qasshëm dhe i ndjekur me lehtësi nga personeli i universitetit.</p>

	<p>[Referenca: RVB; Dokumenti "Rregullore për burimet njerëzore"; Manuali i përdoruesit të sistemit UMIS; UET LMS Guidë për pedagogun]</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Sistemi i brendshëm i menaxhimit të informacionit në Universitetin e Tiranës (UET) ofron akses të dedikuar për personelin akademik dhe studentët në të gjithë fazat e procesit mësimor. Disa pikë kyçe janë:</p> <p>Akses për personelin akademik: Personeli akademik ka akses në databazën e Institucionit në "Dokumenta UET." Kjo u lejon të gjejnë informacion lidhur me çdo hap të procesit mësimor, përfshirë strategjitë, rregulloret, urdhrat administrativ, dhe informacionin tjetër relevante për punën e tyre.</p> <p>Akses për studentët: Studentët kanë akses në informacionin e programit të studimit për lëndët përkatëse në të cilat janë të regjistruar në platformën UET LMS. Kjo u lejon të shfletojnë materialet e mësimin, detyrat e kursit, testet, tezat e provimit, dhe informacionin relevante për programin e tyre të studimit.</p> <p>Ruajtja e të dhënave personale të studentëve: Të dhënat personale të studentëve regjistrohen dhe ruhen në sistemin elektronik të menaxhimit të universitetit (UMIS). Kjo siguron që të dhënat e tyre të jenë të mbrojtura dhe të qasshme kur nevojiten për administratë dhe ndjekje të akademisë.</p> <p>Ky sistem i menaxhimit të informacionit është i rëndësishëm për të siguruar që personeli akademik dhe studentët të kenë akses në të gjitha resurset dhe informacionet që i nevojiten për të ndjekur dhe udhëzuar procesin mësimor në UET.</p> <p>[Referenca: RVB; Dokumenti "Rregullore për burimet njerëzore"; Manuali i përdoruesit të sistemit UMIS; UET LMS Guidë për pedagogun]</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>Bazuar në RVB, konstatohet se personeli akademik dhe studentët mund të komunikojnë virtualisht mes tyre përmes platformës UET LMS dhe Microsoft TEAMS, si edhe nëpërmjet emailit. Studentëve të këtij programi studimi ju vendosen në dispozicion username dhe password si edhe adresat e pedagogëve apo zyra të tjera, ku ata mund të marrin informacionin e nevojshëm për ecurinë e studimeve, përmbushjen e detyrimeve akademike dhe jetës sociale në UET.</p>

	<i>[Referenca: RVB; UET LMS Guidë për pedagogun]</i>			
<b>Kriteri 5.</b> Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.	GVJ nuk ka gjetur informacionin e nevojshëm në RVB apo evidenca për tju përgjigjur këtij kriteri. Gjatë vizitës GVJ kërkoi të informohet për raportet që UET LMS gjeneronte për monitorimin në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ, por nuk mori përgjigje.  <i>[Referenca: RVB; Evidencat shoqëruese në AMS; Vizita në IAL]</i>			
<b>Kriteri 6.</b> Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	Referuar RVB, në faqen zyrtare të UET gjendet informacion lidhur me këtë program studimi, drejtuesit e UET, dhe të dhëna të tjera lidhur me këtë program studimi.  Referuar kontrollit nga GVJ para dhe gjatë vizitës në IAL për faqen zyrtare të UET konstatuam dhe bëmë me dije drejtues të IAL se vetëm nga verifikimi bërë në CV (bio) të disa prej drejtuesve evidentohen gabime në të dhëna nga versioni shqip në anglisht apo anasjelltas.  <i>[Referenca: RVB; Vizita në IAL; Faqja zyrtare e Universitetit European të Tiranës www.uet.edu.al]</i>			
<b>Konkluzione</b>	GVJ për këtë standard nuk eidenton gjetje që mund të ndikojnë deri në mos përmbushjen e standardit.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

#### **Standardi IV.5**

**Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
-----------------	-------------------------------

<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>Referuar RVB-së dhe evidencave shoqëruese konstatojmë se nuk është kthyer përgjigje përsa kërkohet në të dy këto kritere, pasi GVJ konstatoi dhe bëri me dije gjatë vizitës në IAL se të dhënat në tabelën 18.1 ishin konfuzuese pasi ndarjet e mijësheve të shifrave në tabela disa herë ishin me “.” dhe disa herë ishin me “,” dhe për më tepër të dhënat ishin për gjithë UET deri në vitin 2020-2021 dhe jo për këtë program studimi që po vlerësojmë dhe njësinë bazë përgjegjëse për programin e studimit, duke e bërë të pamundur vlerësimin e përmbushjes së këtyre kritereve nga GVJ.</p> <p><i>[Referenca: RVB; Tabelat përmbledhëse; Vizita në IAL]</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të</p>	<p>GVJ nuk evidentoi plan financiar të njësisë bazë.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.</p>	<p>Referuar RVB, UET i nënshtrohet procesit të auditimit çdo vit së pari nga auditimi brendshëm dhe më pas nga auditimi i jashtëm i përzgjedhur nga MAS<sup>2</sup>, duke siguruar çdo vit një raport në lidhje me transparencën financiare, pozicionin financiar, performancën dhe përputhjen me standardet e kërkuara të kontabilitetit duke rezultuar me pasqyra financiare që paraqesin në mënyrë të drejtë në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të tij.</p>

<sup>2</sup> Statuti UET, Kreu VIII, Neni 54, pika 54.5, 54.6 fq. 31 (Ref. Nr. 2)



	<p>Ndërsa, GVJ nga analiza e RVB-së dhe evidencave vlerëson se IAL nuk ka kthyer përgjigje të analizuar e bazuar në evidenca për të vlerësuar efektivitetin financiar të UET dhe në përfundim për t'ju përgjigjur këtij kriteri. Gjithashtu, referuar Statutit të UET, Kreu VIII, pika 54.5 e nenit 54 përcaktohet se UET duhet të këtë Auditues të Brendshëm, ndërkohë kjo njësi nuk gjendet në strukturën organizative të UET si edhe gjatë intervistave nuk kishin përgjigje për ekzistencën dhe veprimtarinë e tij.</p> <p><i>[Referenca: RVB; Evidencat shoqëruese në AMS; Statuti UET; Vizita në IAL]</i></p>			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.	<p><i>GVJ konstaton se nga IAL në RVB nuk është kthyer përgjigje përse kërkon ky kriter.</i></p>			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.	<p><i>GVJ konstaton se mungojnë analizat dhe skenaret e kërkuara për tju përgjigjur këtij kriteri.</i></p> <p><i>[Referenca: RVB; Pasqyrat Financiare dhe Raportet e Auditimit për vitet 2018, 2019, 2020, 2021]</i></p>			
<b>Konkluzione</b>	<p><i>GVJ evidenton se:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li><i>referuar Statutit të UET, Kreu VIII, pika 54.5 e nenit 54 përcaktohet se UET duhet të këtë Auditues të Brendshëm, ndërkohë kjo njësi nuk gjendet në strukturën organizative të UET si edhe gjatë intervistave nuk kishin përgjigje për ekzistencën dhe veprimtarinë e tij;</i></li> </ul>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>

			<b>X</b>	
--	--	--	----------	--

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

### Standardi V.1

**Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>UET ka hartuar dhe zbaton politika dhe procedura të plota që mbulojnë të gjithë ciklin e studimeve universitare, përfshirë programin e studimit të Masterit të Shkencave në "Financë", nga hyrja në dalje, duke respektuar legjislacionin në fuqi. Këto politika janë përcaktuar në Statutin dhe Rregulloren e studimeve universitare përkatëse. Disa pika kyçe janë:</p> <p>Përfaqja me legjislacionin: Institucioni operon në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe zbaton politikat dhe procedurat e nevojshme për të siguruar që programet e studimit të jenë në përputhje me këtë legjislacion.</p> <p>Programi i studimit Master i Shkencave në Financë: Programi i studimit Master i Shkencave në Financë është i organizuar me 120 kredite formimi dhe siguron studentëve njohuri të thelluara dhe profesionale në fushën e financës. Gjuha e zhvillimit të programit është gjuha shqipe.</p> <p>Shërbimet studentore: UET ka një strukturë të mirë-organizuar për shërbimet studentore që mbulon gjithë ciklin e studimit, duke përfshirë periudhën e hyrjes në universitet dhe daljen nga ai. Qëllimi i kësaj strukture është të hartojë dhe zbatojë politika dhe</p>



	<p>procedura për të mbështetur suksesin e studentëve gjatë tërë procesit të studimit.</p> <p>Ndjekja e ecjes së studentëve: Institucioni ndjek ecjen e studentëve gjatë gjithë ciklit të studimit, duke përdorur politika dhe procedura të caktuara për këtë qëllim. Kjo siguron që studentët të kenë mbështetjen dhe udhëzimin e nevojshëm për të arritur sukses në studime.</p> <p>Me këto politika dhe procedura, UET siguron që programet e studimit të jenë të strukturuar në përputhje me standardet e vendosura dhe që studentët të kenë mbështetjen e nevojshme për të përfunduar me sukses ciklin e studimeve universitare.</p> <p><i>[Referenca: RVB; Statuti i UET; Rregullore UET, Kreu 3, pika 1 e Nenit 11; Dokumenti "Mbi politikat, kriteret dhe procesin e pranimit të studentëve"; Dokumenti "Mbi transferimet, njohjen e krediteve dhe mobilitetin"; Dokumenti "Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit"; Dokumenti "Mbi tutoriatin dhe këshillimin akademik"]</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Politikat dhe procedurat në programin e studimit "Master i Shkencave në Financë" nga hyrja në dalje, janë të përcaktuara në mënyrë që të garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e këtij programi. Kriteret dhe procedurat që aplikohen nga hyrja në dalje janë transparente dhe të qarta për të gjithë, duke siguruar barazi dhe të drejta të barabarta për të gjithë kandidatët dhe studentët e programit.</p> <p>Kjo do të thotë që të gjithë ata që janë të interesuar për të bërë pjesë në programin e studimit "Master i Shkencave në Financë" kanë të njëjtat mundësi për aplikim dhe qasje në program. Prosesi i përzgjedhjes dhe kriteret për hyrje janë të njohura dhe të qarta për të gjithë, duke garantuar se aplikantët trajtohen me barazi dhe drejtësi.</p> <p>Këto politika dhe procedura janë të rëndësishme për të siguruar që procesi i aplikimit dhe studimit në programin e Masterit të Shkencave në Financë është i hapur, transparent, dhe i drejtë për të gjithë pjesëmarrësit</p>

	<i>[Referenca: RVB; Rregullore UET, Nenit 11 dhe 38; Rregullore e Programit të Studimit Master i Shkencave në "Financë"]</i>
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.	Referuar RVB, UET nuk aplikon kritere shtesë për pranimin në programin e studimit Master i Shkencave "Financë" përveç atyre të parashikuara në ligj dhe vendime të qeverisë. Nëse do të ketë të tilla, ato janë publike për të gjithë të interesuarit.  <i>[Referenca: RVB; Dokumenti "Mbi politikat, kriteret dhe procesin e pranimi të studentëve"]</i>
<b>Kriteri 4.</b> Kriteret, procedurat e pranimi dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	Studentët mund të gjejnë informacionin e nevojshëm rreth programit të studimit "Master i Shkencave në Financë" në website, si edhe për përparimin gjatë kursit të studimit, transferimin, njohjen e studimeve të mëparshme ose të pjeshme, vlerësimin e njohurive dhe procesin e diplomimit në sistemin e brendshëm.  Aksesi në informacion ndihmon studentët të kenë një kuptim të qartë për detajet e programit të studimit dhe të mundësojë marrjen e vendimeve të informuara për karrierën e tyre dhe përvojën e studimit në "Master i Shkencave në Financë."  Gjatë vizitës në IAL, nga GVJ u kërkuan evidenca të zbatimit të praktikës së transferimit të studentëve. IAL dërgoi evidenca përmes sistemit AMS.  <i>[Referenca: RVB; Rregullore UET, Nenit 11, 35 dhe 38]</i>
<b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	UET informon të interesuarit përmes website, pritjes dhe informimit nga këshilluesit e karrierës, komunikimit me zyrën e pranimeve, takimeve me studentët potencialë (gjimnaz tour), etj. Lidhur me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.  <i>[Referenca: RVB; Dokumenti "Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit"; Dokumenti "Mbi tutoriatin dhe këshillimin akademik"]</i>
<b>Kriteri 6.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti	UET nuk ka kritere përjashtuese për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara,

<p>akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.</p>	<p>por UET respekton kërkesat dhe detyrimet ligjore për publikimin përpara çdo viti akademik të kritereve për të gjithë aplikantët në websitin zyrtar të tij. Për vitin e fundit akademik, UET ka parashikuar kuota për kandidatët me aftësi të kufizuara, jetimë si dhe kandidatë Rome dhe Ballkano Egjiptian.</p> <p><i>[Referenca: RVB; Faqja zyrtare e Universitetit European të Tiranës <a href="http://www.uet.edu.al">www.uet.edu.al</a>; Ligji 802015 "Për arsimin e lartë"; Dokumenti "Mbi politikat, kriteret dhe procesin e pranimit të studentëve"]</i></p>			
<p><b>Kriteri 7.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.</p>	<p>UET nuk ka kritere përjashtuese për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera, por UET respekton kërkesat dhe detyrimet ligjore për publikimin përpara çdo viti akademik të kritereve për të gjithë aplikantët në websitin zyrtar të tij. Për vitin e fundit akademik, UET ka parashikuar kuota për kandidatët nga trojet.</p> <p><i>[Referenca: RVB; Faqja zyrtare e Universitetit European të Tiranës <a href="http://www.uet.edu.al">www.uet.edu.al</a>; Ligji 802015 "Për arsimin e lartë"; Dokumenti "Mbi politikat, kriteret dhe procesin e pranimit të studentëve"]</i></p>			
<p><b>Kriteri 8.</b> Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.</p>	<p>UET ofron bursa të plota ose të pjesshme të studimit në bazë të disa kritereve përzgjedhjeje me qëllim të nxitjes së rezultateve sa më të larta në studime dhe për të kryer një rol të rëndësishëm social. Këto bursa janë të disponueshme për të ndihmuar shtresat e shoqërisë të diskriminuara dhe të nevojshme. UET gjithashtu ofron zbritje të tarifës së shkollimit për aplikantët dhe studentët me rezultate të larta në studime, ata që vijnë nga e njëjta familje, dhe harton politika të ndihmës dhe bursave për shtresat në nevojë. Kjo është një mënyrë për të përmirësuar cilësinë e pranimit në programet e studimit të universitetit dhe për të kontribuar në zhvillimin ekonomik të vendit.</p> <p><i>[Referenca: RVB; Rregullore e UET, Neni 12]</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ nuk evidenton gjetje për këtë standard dhe e vlerëson plotësisht.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

**Standardi V.2**

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>Rregullorja e programit të studimit përfshin procedurat dhe informacionin lidhur me të gjithë përparimin akademik të studentëve. Ajo shqyrton të drejtat dhe detyrat e studentëve, dokumenton vlerësimet, përcakton zhvillimin e provimeve, rregullon të drejtën e hyrjes në provime, dhe përcakton kriteret dhe procedurat e vlerësimit, etj. Gjithashtu, përmes zyrës së pranimeve, zyrës së këshillimit të karrierës dhe sekretarisë së institucionit, jepen informacione të plota dhe të detajuara në lidhje me kriteret dhe procedurat e përparimit akademik të studentëve, si dhe mundësinë e shtyrjes së studimeve në një vit tjetër akademik. Në rastin e programit të Masterit të Shkencave, që zakonisht zgjat 2 vite, këto informacione janë të rëndësishme për studentët për të pasur një kuptim të qartë për rrjedhën dhe rregullat e studimeve të tyre dhe për të planifikuar përparimin e tyre akademik.</p> <p><i>[Referenca: RVB; Rregullore mësimore e programit të studimit MSC "Financë"]</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>UET informon studentët në lidhje me kriteret dhe procedurat e njohjes së kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme, në përputhje me parimet e Kartës së Bolonjës. UET është i hapur për transferime të studentëve në vitet ndërmjetëse nga shkollat e tjera universitare, vendase ose të huaja, publike ose jopublike. Po ashtu, UET-i lejon edhe transferimin e studentëve të tij në shkolla të tjera. Procedura e transferimit fillon me dorëzimin e një kërkesë me shkrim nga studenti dhe përfshin njohjen e lëndëve dhe regjistrimin e tij në programin e ri të studimit. Dokumenti "Mbi transferimet, njohjen e krediteve dhe mobilitetin" përmban politikën e transferimeve dhe njohjes së krediteve dhe shërben për të lehtësuar mobilizimin e studentëve në programet e studimit dhe për t'i ofruar atyre më shumë mundësi për të ndjekur karrierën dhe zhvillimin e tyre akademik.</p> <p><i>[Referenca: RVB; Dokumenti "Mbi transferimet, njohjen e krediteve dhe mobilitetin"; Rregullore e UET; Rregullore mësimore e programit të studimit MSC "Financë"]</i></p>

<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Rregullorja e programit të studimit shpreh mënyrën e vlerësimit të dijeve në lëndët përkatëse në përputhje me tipologjinë e tyre. Ky informacion është gjithashtu në dispozicion për studentët në syllabusin e çdo lënde, që u dorëzohet në javën e parë të mësimit. Kjo transparencë dhe akses në informacion ndihmon studentët të kuptojnë se si do të vlerësohen dhe vlerësimi i tyre do të bazohet në tipologjinë e lëndëve dhe objektivat e programit të studimit.</p> <p>Nga GVJ u pyetën studentët, PAE e PAK, lidhur me sa më sipër dhe në përfundim konstatojmë se ata ishin të mirë informuar.</p> <p><i>[Referenca: RVB; Rregullore e UET; Rregullore mësimore e programit të studimit MSC "Financë"; Syllabuset e lëndëve]</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Dokumenti për punimin e diplomës përcakton planin e diplomimit në mënyrë të detajuar. Kjo përfshin aplikimin për temë diplomash, miratimin e temës dhe pedagogun udhëheqës, shkrimin e tezës, kalendarin e seancave metodologjike, formatimin e punimit, dorëzimin dhe mbrojtjen. Fazat kohore të dorëzimit dhe mbrojtjes së diplomës bëhen të ditura në fillim të çdo viti akademik. Studentët gjithashtu njoftohen me e-mail për çdo veprimtari akademike nga koordinoret e Departamenteve (<i>Studentët e njihnin koordinatoren E.S. pavarësisht se nuk jepte mësim në këtë program studimi</i>). Ky dokument është udhëzues për studentët në procesin e diplomimit dhe i ofron udhëzime të qarta për çdo hap të këtij procesi.</p> <p>Nga GVJ u pyetën studentët lidhur me sa më sipër dhe konstatuam se ishin konfuz me disa prej kërkesave të përcaktuara në dokumentin "Mbi punimin e diplomës dhe disertacionit".</p> <p><i>[Referenca: RVB; Dokumenti "Mbi punimin e diplomës dhe disertacionit"]</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të</p>	<p>Informimi i të interesuarve mbi programin e studimit në UET bëhet përmes organizimit të Ditëve të Hapura për çdo Fakultet, ku kandidatët për studentë kanë mundësinë të marrin pjesë dhe të njihen nga afër me ambientet e universitetit, pedagogët dhe teknikat e mësimdhënies. Këto aktivitete synojnë të ofrojnë një panoramë të qartë për ata që dëshirojnë të ndjekin programin e studimit dhe t'u japin një shans të njohin më mirë çdo aspekt të universitetit.</p>

ardhshëm mbi programin e studimit.	<i>[Referenca: RVB; Rregullore e UET; Politika e marketingut të programit të studimit MSH Financë]</i>			
<b>Konkluzione</b>	GVJ nuk ka gjetje për këtë standard dhe e vlerëson plotësisht.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

### Standardi V.3

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	<p>UET ofron një informacion të detajuar rreth strukturës së programit të studimit, kohëzgjatjes së programit të studimit MSC në "Financë" në rregulloren e tij të programit të studimit.</p> <p>Në të gjithë procesin, që fillon që në momentin e aplikimit dhe regjistrimit, studentët janë të informuar në mënyrë të hollësishme rreth strukturës, organizimit dhe kohëzgjatjes së programit të studimit MSC në "Financë". Këtë informacion ata e marrin nga Zyra e Pranimeve, Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe nga pedagogët. Ky informacion është gjithashtu i disponueshëm në UET LMS, një platformë në të cilën çdo student ka akses.</p> <p>Për maurantët dhe studentët e rinj, UET organizon "Open Days" dhe "Javën e Orientimit" para fillimit të vitit akademik. Këto aktivitete ofrojnë mundësinë për vizitorët të njihen më afër me institucionin, të ndjekin orë mësimi, dhe të marrin informacion të nevojshëm për programet e studimit që ofrohen. Kjo shërben për të bërë procesin e zgjedhjes së programit të studimit më transparent dhe të kuptueshëm për të gjithë interesantët.</p> <p><i>[Referenca: RVB; Rregullore e UET; Rregullore mësimore e programit të studimit MSC "Financë"; Dokumenti "Mbi</i></p>

	<i>funkcionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit”; UET LMS Guide për studentët]</i>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	<p>Studentët janë të pajisur me informacionin e nevojshëm për modulet, lëndët dhe veprimtaritë formuese të programit të studimit në fillim të vitit akademik dhe gjatë studimeve të tyre, duke e marrë këtë informacion nga koordinatori i departamentit dhe pedagogët përkatës. Këto informacione dhe dokumente janë të disponueshme edhe në platformën UET LMS. Kjo siguron që studentët kanë qasje të lehtë në të gjitha informacionet dhe materialet që i nevojiten për të përfunduar me sukses programin e studimit.</p> <p><i>[Referenca: RVB; UET LMS Guide për studentët; Faqe zyrtare e UET]</i></p>
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	<p>UET ofron këshillim të vazhdueshëm për studentët në shumë aspekte të karrierës së tyre, duke përfshirë:</p> <p>a. Ndhimë në hartimin e CV-ve, letrave të motivimit dhe korrespondencës me zyrat e Burimeve Njerëzore të kompanive dhe organizatave. Përveç kësaj, ofron trajnime online dhe offline për përmirësimin e këtyre aftësive.</p> <p>b. Këshillim për përgatitjen për fazat e intervistës së punës, përfshirë praktika dhe sfidat që mund të hasen gjatë kësaj periudhe.</p> <p>c. Informon studentët mbi kalendarin e eventeve të lidhura me industrinë, duke përfshirë Ditët e Hapura për çdo fakultet dhe panairët e punës që ofrojnë mundësi për të lidhur kontakte me kompani dhe organizata.</p> <p>d. Zhvillon sondazhin e planit të karrierës së studentëve për të ndihmuar në kuptimin e punësimit, burimeve të mundshme, praktikave, dhe planet e karrierës së tyre.</p> <p>e. Ofron mentorim dhe ndihmon në krijimin e rrjetit të kontakteve të studentëve. Ky rrjet përfshin burimet dhe partneritet e universitetit, panairët e punës, alumni (ish-studentët), bordet e tregut të punës, grupin e studentëve në LinkedIn, dhe rrjetin e studentëve që kanë bërë praktikë ose kanë marrë pjesë në programet e shkëmbimit si Erasmus. Ky mentorim dhe networking</p>

	<p>ndihmon studentët të lidhin kontakte të rëndësishme dhe të zhvillojnë planin e tyre të karrierës.</p> <p><i>[Referenca: RVB; Rregullore e UET; Dokumenti “Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit”]</i></p>		
<p><b>Kriteri 4.</b> Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Studentët janë të pajisur me informacion mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet që ndihmojnë në realizimin e tij. Ata kanë disa burime për marrjen e informacionit, të tilla si: sekretaria, koordinatorët, Zyrat e Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentëve, UET LMS, website, etj.</p> <p><i>[Referenca: RVB; Rregullore mësimore e programit të studimit MSC “Financë”; Dokumenti “Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit”; Dokumenti “Mbi funksionimin e sekretarisë mësimore”]</i></p>		
<p><b>Kriteri 5.</b> Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p>Siç kemi cituar edhe më sipër, studentët e marrin informacionin lidhur me procesin mësimor lehtësisht edhe përmes faqes zyrtare të UET si dhe platformës UET LMS.</p> <p>Studentët e pyetur nga GVJ, u shprehën se kanë një llogari personale në këtë platformë, që u mundëson të marrin një sërë shërbimesh në distancë. Kjo përfshin qasjen në materialet e mësimit, lëndët, orarin e mësimit, dhe informacione të tjera të nevojshme.</p> <p><i>[Referenca: RVB; UET LMS Guide për studentët; Faqe zyrtare e UET]</i></p>		
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p>GVJ nuk evidenton gjetje për këtë standard.</p>		
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
			X



<b>Standardi V.4</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve të diplomuarve, në programin e studimit.	Zyra të posaçme në UET marrin dhe përpunojnë statistika vjetore të numrit të studentëve dhe të diplomuarve në programin e studimit MSC "Financë" me profile. Përmes Zyrës së zhvillimit të karrierës dhe Alumni, UET mban kontakte të vazhdueshme me ish-studentët. Këto ndihmojnë ata në ndarjen e eksperiencave dhe arritjeve profesionale për krijimin e urave lidhëse midis universitetit dhe tregut të punës. Kjo përmirëson bashkëpunimin dhe ndihmon në rritjen e marrëdhënieve të universitetit me komunitetin e tij të diplomuarve.  <i>[Referenca: RVB; Dokumenti "Të dhëna përmblendhëse për punësimin të studentëve"]</i>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	Sekretaria në UET mbart dhe regjistron të dhëna vjetore në lidhje me numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimit MSC "Financë" me profile, tërheqjet nga ky program, si dhe largimet e studentëve para përfundimit të programit ose mos kalimin në vitin akademik përkatës.  <i>[Referenca: RVB; Dokumenti "Cilësia në hyrje dhe dalje për programin MSC në "Financë"]</i>
<b>Kriteri 3.</b> Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	UET ruan të dhëna për studentët e programit të studimit MSC "Financë" që nga momenti i pranimit deri në diplomim, përfshirë informacion mbi prezencën, vlerësimin, dhe progresin e tyre në lidhje me programin që ndjekin. Ky informacion ruhet dhe administrohet përmes Sistemit të Menaxhimit të Informacionit të Universitetit (UMIS), një program informatik i specializuar për ruajtjen, administrimin dhe përpunimin e të dhënave të studentëve, të dhënave akademike, etj. Përmbajtja e informacioneve dhe njoftimeve lidhur me UMIS është përgjegjësi e personelit të Zyrës IT të universitetit. Për çështjet e punësimit dhe zhvillimit të

	<p>karrierës, Zyra për Zhvillimin e Karrierës dhe Shoqata Alumni janë ato që ndjekin dhe ofrojnë ndihmë studentëve në këto fusha.</p> <p><i>[Referenca: RVB; Dokumenti "Të dhëna përmbledhëse për punësimin të studentëve"; Dokumenti "Mbi funksionimin e sekretarisë mësimore"]</i></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.</p>	<p>GVJ konstaton se për këtë kriter nuk janë dhënë evidenca dhe analizë për përmbushjen e tij nga UET.</p> <p><i>[Referenca: RVB]</i></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<p>GVJ konstaton se për këtë kriter duhet të kishte evidenca dhe më tepër përshkrim narrativ me argumentim të mbështetur mbi fakte konkrete për përmbushjen e tij nga UET.</p> <p><i>[Referenca: RVB; Vizitë në IAL]</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ nuk evidenton gjetje për këtë standard.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

**Standardi V.5**

**Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.</p>	<p>Referuar RVB-së evidentojmë se UET bazuar në statutin e tij dhe rregulloren e institucionit ka përcaktuar dhe inkurajon pjesëmarrjen e studentëve në strukturat vendim-marrëse të universitetit. Institucioni parashikon që studentët dhe/ose përfaqësuesit e tyre të jenë të përfshirë dhe të angazhuar në organet vendim-marrëse dhe këshilluese të tilla si: Këshilli Studentor, Senati Akademik i UET, Dekanat, Këshilli i Etikës, Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Mbledhjet e hapura të departamentit. Këto të krijojnë një perceptim për pjesëmarrje aktive të studentëve në administrim dhe proceset vendimmarrëse të UET.</p> <p><i>[Referenca: RVB; Rregullore e UET; Dokumenti "Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj studentit"]</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>Studentët që janë pjesë e organeve vendim-marrëse të UET njoftohen rregullisht për mbledhjet dhe inkurajohen të marrin pjesë dhe të shprehin pikëpamjen e tyre në këto organe. Studentët, gjithashtu kanë mundësi të përfshihen në vlerësimin e pedagogëve dhe procesin akademik.</p> <p>Gjatë vizitës në IAL, studentët u pyetën se në çfarë organesh vendimmarrëse, këshilluese apo vlerësuese mbi procesin akademik ata ishin të përfaqësuar nga studentë dhe çfarë kishin arritur konkretisht. Përgjigja e tyre ishte vetëm se ishin të përfaqësuar në Senatin Akademik të UET.</p> <p><i>[Referenca: RVB; Rregullore e UET]</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe</p>	<p>Në UET, studentët kanë mundësinë e përfshirjes në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit nëpërmjet angazhimit periodik në mbledhjet e hapura të departamentit dhe në takime të ndryshme. Ata mund të ndajnë</p>

<p>përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.</p>	<p>sugjerime të tyre dhe të japin kontribute të ndryshme që vijnë nga përvoja e tyre. Pra, studentët kanë një rol aktiv në përmirësimin e cilësisë së programeve të studimit dhe përmirësimit të përvojës së tyre të mësimin.</p> <p><i>[Referenca: RVB; Dokumenti "Mbi organizimin dhe funksionimin e Dekanatit dhe Departamentit"; Dokumenti "Formati i vlerësimit të pedagogut nga studentët"]</i></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmerinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultetit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>UET siguron studentëve të drejtën të shprehin mendimin e tyre mbi ndershmerinë e barazinë e procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve. Kjo përfshin të drejtën e tyre për të ankimuar rezultatin, të kërkojnë rishikim dhe të reflektojnë mbi vlerësimin që është bërë nga pedagogu përgjegjës. Provimet sekretohen dhe kështu garantohet edhe anonimiteti i studentit. Pas çdo vlerësimi, studentët informohen rreth rezultateve të tyre. Pas çdo provimi, organizohen seanca sqaruese ku studentët kanë mundësinë të diskutojnë dhe të bisedojnë me pedagogun për vlerësimin dhe mundësinë e rishikimit të tij. Në rast të ankimimit të rezultetit, procedurat janë transparente dhe vlerësimi kryhet përmes një komisioni AD-HOC që përbëhet në nivel departamenti ose fakulteti. Kjo siguron që studentët të kenë një proces vlerësimi të drejtë dhe transparent.</p> <p>Gjatë vizitës në IAL, studentët u pyetën nëse kishin pasur raste të tilla dhe a kishin gjetur drejtësi dhe zbatim të procedurave. Në përgjigjet nga studentët pjesëmarrës u konfirmuan sa më sipër.</p> <p><i>[Referenca: RVB; Rregullore e UET; Rregullore mësimore e programit të studimit MSC "Financë"]</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ nuk ka gjetje për këtë standard.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

**Standardi V.6**

**Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.</p>	<p>UET ka ndërmarrë hapa për të siguruar që studentët e programit të studimit të kenë qasje të lehtë dhe të kuptueshme në të gjitha aspektet e procesit mësimor. Ky qëllim është arritur përmes krijimit të procedurave dhe njësive të veçanta të informimit dhe shërbimit për studentët në përputhje me ligjin dhe aktet rregullatore të UET.</p> <p>Studentët kanë akses të lehtë në informacion dhe dokumentacionit rreth lëndëve, moduleve, përmbajtjes dhe veprimtarive formuese, si dhe të gjithë procesit akademik. Këto informacione dhe dokumenta janë të disponueshme në zyrën e sekretarisë, në UET LMS. Gjithashtu, në fillim të çdo semestri, UET organizon Javën e Orientimit Akademik, ku studentët pajisen me syllabuset e lëndëve dhe informacione të tjera në forma të shkruara dhe elektronike.</p> <p>Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit ka një rol të veçantë në ndihmën dhe mbështetjen e studentëve në gjithë rrugën e tyre të mësimit dhe zhvillimit akademik. Ky angazhim ndihmon që studentët të kenë një përvojë të suksesshme dhe të përmirësojnë cilësinë e studimeve të tyre.</p> <p><i>[Referenca: RVB; Dokumenti "Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit"]</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>UET ofron disa shërbime dhe burime mbështetje për studentët. Këto përfshijnë Zyrën e Pranimeve, Zyrën e Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit, Zyrën e Projekteve dhe Partneriteteve, Këshilluesit Akademik, sekretarinë mësimore, kordinatorët e departamenteve dhe regjistruetit e lëndëve. Përmes këtyre burimeve, studentët mbështeten në çështje që kanë të bëjnë me programin e studimit dhe procesin mësimor. Informacioni dhe këshillimi janë të qasshëm edhe përmes sistemit UET LMS dhe email-it, dhe njoftimet janë të arritshme në këndin e njoftimeve.</p>



	<p>Kjo strukturë e mbështetjes ka për qëllim të ndihmojë studentët në rrugën e tyre drejt suksesit akademik dhe profesional.</p> <p><i>[Referenca: RVB; Dokumenti "Mbi funksionimin e sekretarisë mësimore"]</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit në UET ofron disa shërbime për studentët në zhvillimin e tyre të karrierës. Këshilltarët e karrierës ndihmojnë studentët të përcaktojnë objektivat e tyre dhe të planifikojnë hapat për t'u rritur.</p> <p>Gjatë vizitës në IAL, studentët u pyetën nëse kishin informacion dhe mbështetje për këtë zyrë. Ata nuk kishin asnjë informacion. Në takimin me përgjegjësin e zyrës na informoi se: zyra ishte krijuar vitet e fundit (para 3 viteve) dhe shqetësimet e studentëve/alumni i përcjellin në mbledhjen e Rektoratit. GVJ e bëri me dije për raportet e analizave që duhet të ishin si evidenca për vlerësimin e përmbushjes së këtij kriteri.</p> <p><i>[Referenca: RVB; Dokumenti "Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit"]</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>	<p>Referuar RVB, Zyra për Këshillimin e Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit dhe organizata Alumni ndjekin studentët pas diplomimit duke mbledhur dhe analizuar të dhëna mbi punësimin e tyre. Këto informacione ofrohen studentëve, organeve dhe autoriteteve përkatëse. Zyra gjithashtu ndërmerr masa për të përmirësuar mundësitë e punësimit të studentëve, duke bashkëpunuar me organizatat partnere të UET. Feedback-u në lidhje me këto çështje shpërndahet tek organet drejtuese të UET. Megjithatë, përsëri edhe për këtë kriter mungojnë evidencat që duhet të mbështesin ato çfarë janë cituar më sipër.</p> <p><i>[Referenca: RVB; Dokumenti "Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit"; Tabelë përmbledhëse për punësimin e studentëve]</i></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p>GVJ nuk eidenton gjetje për këtë standard.</p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

## VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

### Standardi VI.1

**Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	<p>Institucioni duket se ka një fokus të qartë në trajnimin e personelit akademik për të ndryshuar metodat dhe stilin e mësimdhënies, duke e vlerësuar si një investim të rëndësishëm për zhvillimin e resurseve njerëzore. Në të njëjtën kohë, përmend një alternativë tjetër për inovacionin e mënyrave të mësimdhënies, duke përfshirë angazhimin e personelit në një punë të thellë kërkimore dhe pedagogjike për të qëndruar në dijeni të zhvillimeve më të fundit në fushën e tyre.</p> <p>Procesi aktual i identifikimit të nevojave për kualifikime të reja në mësimdhënie duket se ndodh nëpërmjet sistemit të brendshëm të menaxhimit të informacionit në bashkëpunim me departamentin e burimeve njerëzore. Përveç kësaj, përmes menaxhimit të performancës për personelin akademik, institucioni duket se ka një qasje për të lehtësuar identifikimin e stafit akademik që vazhdon të përdori metodat e vjetra të mësimdhënies dhe që do të përfitonin nga kualifikimet e reja në fushën e mësimdhënies.</p>

	<p>Gjatë vizitës në IAL, GVJ kërkoi të sjellin si evidencë nëse kanë një udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve. Në përfundim, nuk konstatuam dokument shtesë përsa kërkuar, si rrjedhim GVJ rekomandon UET të hartojë një udhëzues të tillë, në përputhje me kriterin 1, të standardit VI.1.</p> <p><i>[Referenca: RVB; Strategjia e kërkimit shkencor UET 2021-2025; Të dhëna për trajnime profesionale për stafin; Formular i vetëvlerësimit të performancës së personelit akademik; Vizita në IAL]</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>Referuar RVB, personeli akademik dhe ndihmës akademik në këtë IAL përballet periodikisht me trajnime, teste dhe vlerësime nga strukturat përgjegjëse, me qëllim identifikimin dhe vlerësimin e aftësive mësimdhënëse duke filluar nga vlerësimi në auditor nga strukturat udhëheqëse dhe deri te vlerësimi nga vetë studentët. Megjithatë, mund të shprehim skepticizëm në lidhje me efektivitetin e vlerësimit nga ana e tyre, pasi nuk janë dorëzuar evidenca për ekzistencën e raporteve të vlerësimit nga këto struktura dhe çfarë gjetjesh e rekomandimesh mund të kenë dhënë. Gjithashtu nuk u konstatua ndonjë udhëzues/rregullore (përveç sa shprehet në statut: “Academic staff is periodically subject to training, testing and evaluation, specifically defined in the EUT regulatory acts. The Rector sets up an ad-hoc commission for performance evaluation.”) ku mbështetet funksionimi i Komisionit të Vlerësimit të Performancës që ngrihet nga Rektori - (follow-up) të cituar në RVB dhe çfarë raporte vlerësimi kish hartuar lidhur me stafin e angazhuar në këtë program studimi.</p> <p><i>[Referenca: RVB; Statuti UET, Kreu V, Neni 44, pika 3; Formular i vetëvlerësimit të performancës së personelit akademik; Vizita në IAL]</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies,</p>	<p>Politika e vlerësimit të cilësisë së mësimdhënies në UET synon të sigurojë pjesëmarrjen aktive të studentëve në procesin e vlerësimit të pedagogëve dhe orëve të mësimin. Kjo përfshin një vlerësim anonim të pedagogëve. Ky proces organizohet dy herë në vit, para sezonit të çdo semestri për të gjitha programet dhe lëndët. Studentët</p>



<p>të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p>	<p>gjithashtu kanë mundësinë të ngrenë ankimet e tyre përmes mbledhjeve mujore me stafin akademik për të adresuar çështjet dhe problemet që hasin gjatë procesit mësimor. Për studentët që kanë shqetësime në lidhje me vlerësimin e tyre individual, ka një procedurë që fillon me seancat sqaruese brenda 2 javëve nga data e provimit. Në rast të pakënaqësisë, studenti ka të drejtë të drejtohet te Përgjegjësi i Departamentit për rivlerësim, bazuar në rregullat e përcaktuara në nenin 32 të rregullores së UET.</p> <p><i>[Referenca: RVB; Formati i vlerësimit të pedagogut nga studentët ; Formular për ankesat e studentëve; Rregullore UET ,Neni 27, pika 27.9 dhe Neni 32; Vizita në IAL]</i></p>
<p><b>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</b></p>	<p>Përfshirja e strukturave përgjegjëse për monitorimin periodik të cilësisë në mësimdhënie, në fund të çdo semestri duhet të synojë publikimin e rezultateve të vlerësimit të arritura. Rezultatet e vlerësimit, pasi përpunohen nga KSBC ose zyra e IT në rastin e vlerësimeve online, raportohen tek autoritetet drejtuese të UET dhe anëtarët e personelit akademik nga Përgjegjësi i Departamentit. Nga verifikimi bërë prej GVJ nuk u konstatua asnjë publikim në website të UET lidhur me plotësimin e këtij kriteri për bërjen publike të rezultateve të vlerësimit nga strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie. Gjithashtu, gjatë vizitës në IAL, nga një prej të intervistuarve këmbëngulej se nuk duhet të plotësohet ky kriter.</p> <p><i>[Referenca: RVB; Website UET; Vizita në IAL]</i></p>
<p><b>Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</b></p>	<p>U kërkua nga GVJ dhe nuk u evidentuan praktika konkrete në të cilat UET nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra nga anketimet e studentëve apo format e tjera të kishte promovuar raste konkrete dhe të evidentonte ato si shembuj të praktikave të mira, me qëllim nxitjen e personelit akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies. Edhe referenca e vendosur në RVB se veprohej sipas rregullores së UET, Neni 45, pika 5, nuk korespondon me përgjigjen për këtë kriter.</p> <p><i>[Referenca: RVB; Rregullore e UET, Kreu V; Vizita në IAL]</i></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p>GVJ konstaton:</p>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• mungesë të një udhëzuesi në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.</li> <li>• mungesë të një udhëzuesi në nivel institucional për funksionimin e Komisionit të Vlerësimit të Performancës që ngrihet nga Rektori.</li> <li>• Mungesë të publikimit në website të UET për bërjen publike të rezultateve të vlerësimit nga strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie.</li> </ul>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

### Standardi VI.2

**Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	Referuar RVB, strukturat specifike për sigurimin e standardeve dhe cilësisë në UET përfshijnë Zyrën e Standardeve dhe Cilësisë, Komisionin e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Zyrën e Burimeve Njerëzore dhe Zyrën e Kurrikulave. Por, përgjegjësia për sistemin e brendshëm të sigurimit të cilësisë i takon Zyrës së Standardeve dhe Cilësisë (Vendimi i emërimit të tyre dhe udhëzimi/rregullore e funksionimit të kësaj zyre nuk është dhënë si evidencë në DVV), në bashkëpunim me Zyrën e Kurrikulave. Në nivel universiteti, Komisionet e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë janë themeluar me anëtarë të zgjedhur nga personeli akademik dhe përfaqësues të studentëve.  [Referenca: RVB; Statuti UET; Rregullore e UET; Ligji 80/2015]
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për	Referuar DVV evidentohet se në UET, Komisioni për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (KSBC) është ngritur bazuar në 1 vendim të Senatit Akademik të marrë në datë 17 Dhjetor 2020 me 11 anëtar si edhe 1 Urdhër Administrativ të Rektorit të datës 12 Nëntor 2021 duke e rikompozuar atë me 12 anëtar. Konstatohet se mbi 70% e anëtarëve të KSBC nuk kanë grada shkencore apo tituj akademik,

<p>përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>si edhe nuk shprehet çfarë kohëzgjatje kanë mandatet e tyre. Përfaqësuesit në KSBC përbëhen nga kryetari i Komisionit, përfaqësues nga fakultetet, stafi administrativ, një përfaqësues ekspert jashtë institucionit dhe përfaqësues nga Këshilli Studentor. Këtë të fundit studentët e intervistuar gjatë vizitës në IAL nuk e dinin dhe nuk e njihnin se kush ishte. Vlerësohet si praktikë e mirë që IAL ka një dokument të miratuar si Strategji për Sigurimin e Cilësisë për periudhën 2023-2028.</p> <p><i>[Referenca: RVB; Statuti UET; Rregullore e UET; Ligji 80/2015; Strategjia për sigurimin e brendshëm të cilësisë 2023-2028; Vizita në IAL]</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.</p>	<p>UET është kujdesur për sigurimin e cilësisë për këtë program studimi përmes vlerësimit të jashtëm dhe procesit të akreditimit përmes ASCAL. Për të adresuar rekomandimet e marra nga Bordi Akreditimit, UET ka integruar masa për të përmirësuar administrimin e tij.</p> <p><i>[Referenca: RVB; Statuti UET; Rregullore e UET; Ligji 80/2015]</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.</p>	<p>GVB shprehet se UET ka një strukturë vlerësimi dhe monitorimi të programit studimor, dhe se KSBC organizon aktivitete monitoruese dhe vlerësuese për proceset akademike, por nuk specifikohet se si ky monitorim dhe vlerësim përdoret për të përmirësuar cilësinë e programeve të studimit. Mungesa e informacionit rreth veprimeve konkrete të ndërmarra pas vlerësimeve të KSBC për të adresuar çështjet e përcaktuara, mund të nxisë dyshime lidhur me efikasitetin dhe ndikimin e këtyre proceseve në përmirësimin e cilësisë.</p> <p><i>[Referenca: DVV; Ligji 80/2015; Vizita në IAL]</i></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ konstaton:</i></p>



	<ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Mungesë qëndrueshmërie në Komisionin për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (KSBC) të ngritur bazuar në 1 vendim të Senatit Akademik të marrë në datë 17 Dhjetor 2020 me 11 anëtar si edhe 1 Urdhër Administrativ të Rektorit të datës 12 Nëntor 2021 duke e rikompozuar atë me 12 anëtar. Konstatohet se mbi 70% e anëtarëve të KSBC nuk kanë grada shkencore apo tituj akademik, si edhe nuk shprehet çfarë kohëzgjatje kanë mandatet e tyre.</i></li> <li>• <i>Vlerësohet si praktikë e mirë që IAL ka një dokument të miratuar si Strategji për Sigurimin e Cilësisë për periudhën 2023-2028.</i></li> </ul>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

### Standardi VI.3

**Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim.</p> <p>Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe</p>	<p>Në RVB shprehet se UET harton dhe ndan raporte periodike për vlerësimin e procesit të shqyrtimit, miratimit dhe mbikëqyrjes së programeve të studimit. Por, mungesa e evidencave konkrete në DVV, mund të nxisë dyshime lidhur me efikasitetin dhe ndikimin e këtyre mekanizmave në përmirësimin e cilësisë.</p> <p><i>[Referenca: DVV]</i></p>

vendimmarrëse për programin e studimit.	
<p><b>Kriteri 2.</b> Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p>	<p>RVB shprehet se raportet e vlerësimit në UET përfshijnë rezultatet e pritshme, vlerësimet e bëra dhe masat e ndërmarra për adresimin e mangësive në cilësi. Raportet e vlerësimit konfirmojnë përputhjen e aktiviteteve me rregulloret dhe standardet e cilësisë, si dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët. Por, mungesa e evidencave konkrete në DVV, mund të nxisë dyshime lidhur me efikasitetin dhe ndikimin e këtyre masave në përmirësimin e cilësisë.</p> <p><i>[Referenca: DVV]</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>Referuar RVB, UET përdor metoda të drejtpërdrejta për të vlerësuar cilësinë e programit të studimit, duke përfshirë cilësinë e mësimdhënies, kurrikulën, didaktikën, provimet, detyrat e studentëve, vlerësime të punës së pedagogëve gjatë semestrit nga kryerja e orëve monitoruese në leksione, rishikimet vjetore të syllabuseve të lëndëve, përfshirjen e eksperiencave më të mira ndërkombëtare, rezultatit e angazhimit të stafit akademik në projekte, dhe analizën e infrastrukturës në dispozicion të procesit mësimor. Por, mungesa e evidencave për aplikimin konkret të tyre në DVV, mund të nxisë dyshime lidhur me efikasitetin dhe ndikimin e këtyre metodave në përmirësimin e cilësisë.</p> <p><i>[Referenca: DVV; Vizita në IAL]</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e</p>	<p>Referuar DVV, IAL përdor metoda dhe mjete të ndryshme për vlerësimin e cilësisë së programit të studimit. Këto përfshijnë pyetësorët online në UET LMS, fokus grupet, mbledhjet me ish-studentët (alumni) për të përshpejtuar pjesëmarrjen e tyre në aktivitete dhe shkëmbimin e përvojave në UET. Aktivitete të tjera</p>

<p>instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.</p>	<p>si Panairi i Përvitshëm i Punës, mbledhjet e stafit akademik, ndihma akademike, vizitat monitoruese nga drejtuesit akademikë si dekani apo përgjegjësit e grupeve mësimore, janë gjithashtu të rëndësishme për vlerësimin e diturive dhe kompetencave që ofron ky program studimi. Por, mungesa e evidencave në DVV për të vërtetuar aplikimin e sa më sipër, mund të nxisë dyshime lidhur me efikasitetin dhe ndikimin e këtyre metodave në përmirësimin e cilësisë së programit të studimit.</p> <p><i>[Referenca: DVV; Strategjia për sigurimin e brendshëm të cilësisë 2023-2028; Vizita në IAL]</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ konstaton mungesë të evidencave në DVV për të vërtetuar aplikimin konkretë të mekanizmave, masave, metodave dhe teknikave, për të vërtetuar zbatimin me efikasitetit dhe ndikimin e tyre në përmirësimin e cilësisë së programit të studimit</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>	

**Standardi VI.4**

**Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Strukturat përgjegjëse të sigurimit të cilësisë brenda në UET kanë politika dhe procedura të brendshme për sigurimin dhe avancimin e cilësisë së programit të studimit. Vlerësimi synohet të kryhet në përputhje me rregullat e institucionit, objektivat strategjike, dhe misionin e UET. Këto parime dhe aktivitete për sigurimin e cilësisë mbështeten në dokumentacionin rregullator të institucionit, duke përfshirë standardet europiane dhe ato kombëtare. Struktura dhe detyrat e zyrave përcaktohen qartë, ndërsa studentët luajnë një rol të rëndësishëm në procesin e vlerësimin, duke përfshirë pjesëmarrjen e tyre në strukturat vendimmarrëse dhe shprehjen e</p>

	<p>mendimeve nëpërmjet formave të ndryshme të vlerësimit si pyetësorë dhe fokus grupet.</p> <p><i>[Referenca: DVV; Strategjia për sigurimin e brendshëm të cilësisë 2023-2028; Manuali për sigurimin e brendshëm të cilësisë]</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Referuar RVB, IAL ka të përcaktuar në manual dhe rregullore detyra dhe përgjegjësi specifike për të gjithë ata të përfshirë në sigurimin e cilësisë së programit të studimit. Strategjia për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë përshkruan sistemin dhe funksionimin e tij në lidhje me parimet, qëllimin, strukturën dhe përgjegjësitë, duke përfshirë trajnimet dhe angazhimin e studentëve.</p> <p><i>[Referenca: RVB; Strategjia për sigurimin e brendshëm të cilësisë 2023-2028; Manuali për sigurimin e brendshëm të cilësisë]</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve të programit të studimit.</p>	<p>Njësia bazë e ajo kryesore së pari përfshihen përmes përfaqësuesve të tyre në KSBC. Personeli akademik i këtij programi studimi informohet me rezultatet dhe raportet komisionit dhe kërkohet të kontribuohet prej tyre në mënyrë të vazhdueshme me analiza dhe sugjerime.</p> <p><i>[Referenca: RVB; Strategjia për sigurimin e brendshëm të cilësisë 2023-2028; Manuali për sigurimin e brendshëm të cilësisë]</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>IAL kujdeset të sigurojë pjesëmarrjen dhe mobilizimin e personelit brendshëm në proceset e vlerësimit në përputhje me statutin dhe rregulloret si edhe duke respektuar integritetin akademik dhe parandaluar diskriminimin ose pabarazitë ndaj personelit dhe studentëve të shprehura në Kodin e Etikës së UET.</p> <p><i>[Referenca: RVB; Strategjia për sigurimin e brendshëm të cilësisë 2023-2028; Manuali për sigurimin e brendshëm të cilësisë; Kodi i Etikës]</i></p>

<p><b>Kriteri 5.</b> Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p>	<p>Referuar vendimit të senatit akademik të UET për zgjedhjen e anëtarëve të KSBC konstatojmë se në përbërje të tij ka edhe ekspertë të jashtëm. Gjithashtu, opinionet e bashkëpunëtorëve të jashtëm mund të merren edhe gjatë takimeve në aktivitete si panairi i punës, etj.</p> <p><i>[Referenca: DVV]</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ për këtë standard nuk ka gjetje materiale të pa evidentuara më herët.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

<p><b>Standardi VI.5</b>  <b>Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>	<p>Kuadri rregullator dhe strategjia për sigurimin e cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe ju bëhen me dije studentëve dhe gjithë të interesuarve.</p> <p><i>[Referenca: RVB; Faqja zyrtare e Universitetit European të Tiranës]</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe</p>	<p>RVB citon se: “UET publikon në faqen zyrtare rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit (RVB), duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale dhe informacionit të mësuar apo vënë në dispozicion, të konsideruar konfidencial”. Gjithashtu, siç e kërkon edhe ky kriter, rregullorja e UET parashikon publikimin e</p>



<p>legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>aktiviteteve, duke përfshirë edhe ato për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, në faqen zyrtare të UET.</p> <p>GVJ kontrolli faqen zyrtare të UET dhe nuk gjeti të publikuar (siç e kërkon kriteri 2, Standardi VI.5) <b>rezultatet e vlerësimeve të programit të studimi të bërë nga KSBC dhe as RVB e këtij programi studimi të bërë nga GVB.</b></p> <p><i>[Referenca: RVB; Faqja zyrtare e Universitetit European të Tiranës]</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>Mungesë e evidencave në DVV për të vërtetuar që UET ka plan masash që adresojnë dhe synojnë plotësimin e mangësive dhe reduktimin apo eliminimin e dobësive të evidentuara nga vlerësimet e KSBC, nxitë dyshime lidhur me efikasitetin dhe ndikimin e funksionimit të strategjisë për sigurimin e brendshëm të cilësisë për këtë program studimi.</p> <p><i>[Referenca: DVV; Strategjia për sigurimin e brendshëm të cilësisë 2023-2028]</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>IAL kujdeset për përmirësime dhe rishikime të përvitshme në strukturën e programeve të lëndëve, si dhe zgjerimin e kurrikulave për të përfitur nga pjesëmarrja në projekte ndërkombëtare dhe nga veprimtaria individuale kërkimore-shkencore e personelit akademik në fushat e tyre të specializimit. Megjithatë, nga verifikimi në DVV nuk gjenden evidenca të konkretizojnë këto masa të ndërmarra për këtë program studimi.</p> <p><i>[Referenca: DVV]</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Referuar RVB evidentohet se IAL kujdeset për plotësimin e kriterit 5, standardi VI.5, megjithatë si edhe në kriteret e tjera më sipër edhe këtu mungojnë evidencat për të vërtetuar konkretisht përsa kërkohet në zbatim të këtij kriteri.</p> <p><i>[Referenca: DVV]</i></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p>GVJ konstaton:</p>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Mungesë të publikimit të rezultateve të vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</li> <li>• Mungesë evidencash për të faktuar plotësimin e kritereve.</li> </ul>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

**Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave ne “Finance” me 3 profile ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë “Universiteti European i Tiranës”**

**Pikat e forta dhe afirmime**

1. *Eksperiencia e programit dhe përmirësimi i tij nëpërmjet 3 profileve me orientim kërkesat e tregut të punës..*
2. *Eksperiencia e stafit akademik të përfshirë në programin e studimit dhe mbulimi i tij me staf akademik me kohë të plote ( nga 15 personel akademik i angazhuar në këtë program 14 prej tyre janë PAE).*
3. *Struktura solide që lidhen me mbështetjen e studentëve përgjatë studimeve dhe pas tyre.*
4. *Një bazë Alumni e fortë për të mbështetur rezultatet e programit në lidhje me të nxënin, cilësitë dhe aftësitë e të diplomuarve.*
5. *Bashkëpunimi i ngushtë me aktorët e tregut të punës, nëpërmjet takimeve periodike të organizuara me ta, si dhe eficaenca e Bordit të Punës*

**Pika të dobëta**

1. *Angazhim në mësimdhënie e personelit akademik që nuk ka tituj akademik apo gradë shkencore ka krijuar mospërputhje me kërkesat ligjore në fuqi. Standardi (IV.1)*




2. *Mungesa e njësisë së Auditimit të Brendshëm ka krijuar mospërputhje me Statutin e UET, Kreu VIII, pika 54.5 e nenit 54 përcaktohet se UET duhet të këtë Auditues të Brendshëm. Standardi (IV.5)*
3. *Mungesa e publikimit në website të IAL-së të rezultateve të vlerësimit nga strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie, si edhe axhornimit të saktë të informacioneve të publikuara në website të IAL-së. Standardi (VI.1)(VI.5)*
4. *Mungesa e arritjeve akademike për anëtarët e Komisionit për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (KSBC) sepse mbi 70% e tyre nuk kanë grada shkencore apo tituj akademik. Standardi (VI.2)*

#### **Rekomandime**

1. *Të angazhojë si personel akademik në mësimdhënie vetëm pedagogë të cilët janë të kategorisë profesor apo të zotërojnë gradë shkencore. Standardi (IV.1)*
2. *Të shtojë në strukturën organizative njësinë e Auditimit të Brendshëm në zbatim të Statutit të UET, Kreu VIII, pika 54.5 e nenit 54. Standardi (IV.5)*
3. *Të marrë masat të publikojë në website të UET rezultatet e vlerësimit nga strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale. Standardi (VI.1)(VI.5)*
4. *Të shtojnë anëtarë me arritje akademike (Profesor; Profesor i Asociuar; Doktor i Shkencave) në Komisionin për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (KSBC). Standardi (VI.2)*
5. *Për një efikasitet me të mirë të realizimit të punimit përmbyllës të studentëve, rekomandojmë që numri i udhëheqjeve të studentëve nga një pedagog të jete më i ulët. (Standardi III.5)*

**Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit**

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
<b>I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT</b>				X
<b>II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË</b>				X
<b>III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT</b>				X
<b>IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT</b>				X
<b>V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE</b>				X
<b>VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT</b>			X	
<b>VLERËSIMI TËRËSOR</b>				X

